FEJA ISLAME

UDHËRRËFYES PËR NJERËZIT MBI BAZAT DHE ÇËSHTJET KRYESORE TË FESË ISLAME

PYETJE DHE PËRGJIGJE

PARATHËNIE NGA:

ISH-MYFTIU I ARABISË SAUDITE ABDUL'AZIZ AL ESH-SHEJKH
MYFTIU I ARABISË SAUDITE SALIH EL-FEUZAN
DIJETARI I MADH SALIH AL ESH-SHEJKH

UMER BIN ABDURRAHMAN EL-UMER

Feja Islame
Udhërrëfyes për njerëzit
mbi bazat dhe çështjet kryesore
të fesë Islame

Autor: Umer bin AbduRrahman el-Umer

Përktheu: Servet Mata

Feja Islame - Udhërrëfyes për njerëzit mbi bazat dhe çështjet kryesore të fesë Islame

Titulli në origjinal: إِرْشَادُ الْأَنَامِ إِلَى أُصُولِ وَمُهِمَّاتِ دِيْنِ الْإِسْلَامِ

Autor: Umer bin AbduRrahman el-Umer

Përktheu: Servet Mata

Redaktoi: Jeton Shasivari

Botim i parë

© E drejta e autorit 2026 nga selefi-al.com

Botuesi posedon çdo të drejtë. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të kopjohet e të shpërndahet në asnjë mënyrë, apo të ruhet në ndonjë sistem regjistrimi apo memorizimi të asnjë lloji, pa marrë paraprakisht lejen e botuesit.

Tiranë, 2026

الحمدلله رب العالمين والصلاة والسلام على نبينا محمد وعلى آله وصحبه اجمعين ،،،

فقد أذنت للأخ الفاضل ثروت ماتى من ألبانيا وخريج الجامعة الإسلامية في المدينة النبوية جزاه الله خيرا بترجمة كتابي إرشاد الأنام إلى أصول ومهمات دين الإسلام وكذلك كتابي الثاني الأجوبة الشافية على أسئلة مهمة في ضوء الإسلام.

وأسأل الله تعالى أن ينفع بهذين الكتابين عموم المسلمين وغير المسلمين والله الهادي إلى سواء السبيل ،،

رئيس مجلس الإدارة

جمعية الدعوة والارشاد
وتوعية الجاليات بالثمامة
Islamic Center in Thumamah
رقم التسجيل ٣٥٢٩

د.عمر بن عبدالرحمن العمر

Lavdia dhe falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve. Mëshira dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi Profetin tonë Muhammedin, mbi familjen e tij dhe mbi të gjithë shokët e tij.

I kam dhënë leje vëllait të nderuar, Servet Mata nga Shqipëria, të diplomuar në Universitetin Islamik në Medinen Profetike – Allahu e shpërbleftë me të mira – për përkthimin e librit tim "Udhërrëfyes për njerëzit mbi bazat dhe çështjet kryesore të fesë Islame", si dhe të librit tim të dytë "Përgjigje të qarta për pyetje të rëndësishme në dritën e Islamit".

E lus Allahun e Lartësuar që nëpërmjet këtyre dy librave t'u sjellë dobi të gjithë muslimanëve dhe jomuslimanëve. Allahu është Ai që udhëzon drejt rrugës së drejtë.

Shkroi: Umer ibn AbduRrahman el-Umer

Përmbajtja

Parathënie e Shkëlqesisë së tij, ish-Myftiut të Përgjithshëm të Mbretërisë së Arabisë Saudite! 12

Parathënie e Shkëlqesisë së Tij, Myftiut të Përgjithshëm të Mbretërisë së Arabisë Saudite 13

Parathënie e Shkëlqesisë së Tij, Shejkh Salih bin Abdul'Aziz bin Muhammed Al esh-Shejkh, ish-Ministër i Çështjeve Islame, Thirrjes dhe Udhëzimit, Ministër i Shtetit dhe anëtar i Këshillit të Ministrave 14

Parathënie e autorit 15

1. Kapitulli i Tre Parimeve *(el-usulu eth-thelatheh)* 16

1. Cilat janë tre parimet që është detyrë për çdo musliman dhe muslimane t'i njohë? 16
2. Kush është Zoti yt? Dhe cili është argumenti? 16
3. Si e ke njohur Zotin tënd? Dhe cili është argumenti? 16
4. Cila është feja jote? Dhe cili është argumenti? 17
5. Cilat janë gradat e fesë? 17
6. Kush është Profeti yt? Dhe cili është argumenti? 17

2. Kapitulli: Shtyllat e Islamit dhe kuptimi i dy shehadeteve! 18

7. Cilat janë shtyllat e Islamit? 18
8. Cili është kuptimi i dëshmisë: "La ilahe il-lAllah" dhe cili është argumenti për të? 18
9. Cilat janë shtyllat e dëshmisë "La ilahe il-lAllah" dhe cili është argumenti për to? 18
10. Cilat janë kushtet e fjalës "La ilahe il-lAllah"? 19
11. Çfarë është ajo që kërkohet nga dëshmia "La ilahe il-lAllah"? 19
12. Cili është kuptimi i dëshmisë "Muhammedi është i Dërguari i Allahut" [Muhammedun Resulull-Llah], dhe cili është argumenti për të? 20
13. Çfarë është ajo që kërkohet nga dëshmia se Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, është i Dërguari i Allahut? 20

3. Kapitulli: Shtyllat e imanit dhe frytet e tij! 21

14. Cilat janë shtyllat e imanit? 21

15. Çfarë do të thotë besimi në Allahun e Lartësuar? 21
16. Cilat janë frytet e besimit në Allahun e Lartësuar? 21
17. Çfarë do të thotë besimi në melaiket (engjëjt)? 22
18. Cilat janë frytet e besimit në engjëjt? 22
19: Çfarë është besimi në Librat e shpallur? 22
20: Cilat janë frytet e besimit në Librat e shpallur? 23
21. Çfarë do të thotë besimi në të Dërguarit? 23
22. Cilat janë frytet e besimit në të Dërguarit? 23
23. Çfarë është besimi në Ditën e Gjykimit? 24
24. Cilat janë frytet e besimit në Ditën e Gjykimit? 24
25. Çfarë është besimi në Kaderin, të mirën dhe të keqen e tij? 24
26. Cilat janë frytet e besimit në Kaderin, të mirën dhe të keqen e tij? 25
4. Kapitulli: Ihsani dhe frytet e tij! 27
27. Çfarë është ihsani? 27
28. Cilat janë gradat e ihsanit? 27
29. Cilat janë frytet e ihsanit? 27
5. Kapitulli: Teuhidi dhe virtytet e tij! 28
30. Çfarë është teuhidi? Cilat janë llojet e tij? 28
31. Çfarë është Teuhidi Rububijjeh? 28
32. A mjafton Teuhidi Rububijjeh për të hyrë në Islam? 28
33. Cila është rëndësia e Teuhidit Rububijjeh? 28
34. Çfarë është Teuhidi Uluhijjeh? 29
35. Cila është rëndësia e Teuhidit të Uluhijjeh? 29
36. Çfarë është Teuhidi i Emrave dhe Cilësive? 29
37. Cila është metodologjia e Ehli Sunetit dhe Xhematit në Teuhidin e Emrave dhe Cilësive? 30
38. Cila është rëndësia e Teuhidit të Emrave dhe Cilësive? 30
39. Cilat janë virtytet e Teuhidit? 31
6. Kapitulli: Rriddeja [Dalja nga Islami] 32
40. Çfarë është Rriddeh dhe cili është argumenti për të? 32
41. Cilat janë llojet e Rriddesë? 32
42. Cilat janë shembujt e Rriddesë me fjalë? 32

43. Cilët janë shembujt e Rriddesë me vepra? 33
44. Cilat janë shembujt e Rriddesë në akide (besim)? 33
45. Cilët janë shembujt e Rriddesë me dyshim? 34
46. Cili është shembulli i Rriddesë me braktisje (lënie)? 34
7. Kapitulli: Shirku në adhurim 35
47. Çfarë është shirku? Cilat janë llojet e shirkut në adhurim? 35
48. Çfarë është shirku i madh? 35
49. Përmend disa shembuj të shirkut të madh. 35
50. Cilat janë pasojat e shirkut të madh? 35
51. Cilat janë shkaqet e rënies në shirkun e madh? 36
52. Çfarë është shirku i vogël? 36
53. Përmend llojet e shirkut të vogël. 36
54. Cili është dallimi ndërmjet shirkut të madh dhe shirkut të vogël? 37
8. Kapitulli: Nifaku [hipokrizia] 38
55. Çfarë është nifaku? Cilat janë llojet e tij? 38
56. Çfarë është nifaku në besim? 38
57. Cilat janë llojet e nifakut në besim? 38
58. Çfarë është nifaku në vepra? 38
59. Cili është dallimi ndërmjet nifakut në besim dhe nifakut në vepra? 39
9. Kapitulli: Adhurimi i ligjësuar dhe bidatet (shpikjet) e ndaluara! 40
60. Përse na ka krijuar Allahu i Lartësuar? Cili është argumenti për këtë? 40
61. Çfarë është adhurimi? 40
62. Cilat janë kushtet për pranimin e adhurimit? 40
63. Çfarë është sinqeriteti (ikhlasi) për Allahun e Lartësuar? 40
64. Cili është argumenti për obligueshmërinë e ikhlasit ndaj Allahut të Lartësuar? 40
65. Çfarë është pasimi i të Dërguarit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*? 41
66. Cili është argumenti për obligueshmërinë e pasimit të të Dërguarit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*? 41
67. Çfarë është bidati në fe? 41
68. Cili është gjykimi i bidatit në fe? Përmendni argumentin. 41

69. Cilat janë llojet e bidateve në fe? 42
70. Përmend shembuj të bidatit në fe. 43
71. Cilat janë shkaqet e rënies në bidate? 43
10. Kapitull përmbledhës rreth akides së Ehli Sunetit dhe Xhematit 44
72. Cili është grupi i shpëtuar prej Zjarrit prej grupeve të muslimanëve? 44
73. Kush janë pasuesit e sunetit dhe xhematit? 44
74. Cili është shkaku i emërtimit të tyre me emrin Pasuesit e Sunetit dhe Xhematit? 44
75. Cili është shkaku i emërimit të tyre me Selefije? 44
76. Cili është argumenti se pasuesit e sunetit dhe xhematit janë grupi i shpëtuar? 45
77. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit lidhur me pohimin e Cilësisë së Allahut se Ai qëndron mbi krijesat e Tij (el-'ulu), si dhe Cilësisë së Tij të lartësimit (istiuasë)? 45
78. Cili është argumenti prej Kur'anit fisnik për pohimin e Cilësisë së qëndrimit të Allahut mbi krijesat e Tij? 46
79. Cili është argumenti prej sunetit për pohimin e Cilësisë së qëndrimit të Allahut mbi krijesat e Tij? 46
80. Cili është argumenti për pohimin e Cilësisë së Lartësimit të Allahut mbi Arsh? 46
81. Çfarë do të thotë el-istiua? 47
82. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me Kur'anin fisnik? 47
83. Cili është argumenti se Kur'ani fisnik është Fjalë e Allahut të Lartësuar? 47
84. Cili është argumenti se Kur'ani fisnik është i shpallur, i zbritur dhe nuk është i krijuar? 48
85. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me shikimin e Allahut të Lartësuar? 48
86. Cili është argumenti se besimtarët do ta shohin Zotin e tyre në Botën tjetër? 48
87. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me imanin? 49
88. Cili është argumenti se fjala dhe vepra janë prej imanit? 49
89. Cili është argumenti se imani shtohet dhe pakësohet? 50
90. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me atë që bën mëkate të mëdha? Shoqëroje përgjigjen me argumentin përkatës 50
91. Çfarë gjykimi ka shpallja kafir (mosbesimtar) e një besimtari? Cili është argumenti për këtë? 50
92. Cili është qëndrimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me sprovën e varrit, shpërblimin në të dhe dënimin në të? Cili është argumenti për këtë? 51

93. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me domosdoshmërinë e qëndrimit me xhematin? Përmendni edhe argumentin. 51
94. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me bindjen ndaj prijësit? Përmendni edhe argumentin. 51
95. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me sahabët (shokët e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*)? 52
96. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me familjen (Ehli Bejtin) e të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*? 53
97. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me dashurinë (el-uelaa) dhe urrejtjen (el-beraa)? 53
98. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me Isain (Jezusin), *alejhis-selam*. 53
99. Cili është qëndrimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me fetë e tjera, si Hebraizmi dhe Krishterimi? 54
100. Cili është argumenti nga Kur'ani fisnik se feja Islame është feja e vërtetë, ndërsa çdo fe tjetër përveç saj është e kotë? 54
101. Cili është argumenti nga Suneti që tregon obligueshmërinë e besimit te Profeti Muhammed, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe në atë me të cilën është dërguar? 54
102. Cili është qëndrimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me tekstet e Kur'anit dhe sunetit? Përmend argument për këtë. 55
103. Cili është qëndrimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me xhihadin në rrugë të Allahut? Cili është synimi i tij dhe cilat janë kushtet më të rëndësishme të tij? 55
104. Cili është qëndrimi i pasuesve të Sunetit dhe Xhematit ndaj veprimeve të grupeve terroriste, të cilat ata i quajnë "xhihad"? 56
11. Kapitulli i abdesit dhe i guslit 57
105. Çfarë do të thotë abdes? 57
106. Cili është argumenti se abdesi është obligim për të falur namazin? 57
107. Cilat janë kushtet e abdesit? 57
108. Cilat janë obligimet e abdesit? 58
109. Cila është mënyra e kryerjes së abdesit? 58
110. Cilat janë gjërat që ta prishin abdesin? 60
111. Çfarë do të thotë gusël? 60
112. Cilat janë shkaqet që e bëjnë të detyrueshëm guslin? 60
113. Cili është argumenti për obligueshmërinë e guslit për shkak të ndonjë prej gjërave që e bëjnë obligim atë? 60

114. Cila është mënyra e kryerjes së guslit? 61
115. Cilat janë dobitë e abdesit dhe të guslit? 61
12. Kapitulli i namazit 62
116. Çfarë do të thotë namaz? 62
117. Cilat janë namazet e detyrueshme për çdo musliman dhe muslimane? 62
118. Cili është argumenti për obligueshmërinë e namazit? 62
119. Cili është gjykimi për lënien (mosfaljen) e namazit dhe cili është argumenti? 63
120. Cilat janë kushtet (shurutet) e namazit? 63
121. Cilat janë shtyllat (arkanet) e namazit? 63
122. Cila është rëndësia e sures el-Fatihah? 64
123. Cilat janë obligimet (uaxhibatet) e namazit? 65
124. Cili është teshehhudi i parë? 65
125. Kur bëhet teshehhudi i parë? 65
126. Cili është teshehhudi i fundit? 65
127. Kur bëhet teshehhudi i fundit? 66
128. Cilat janë sunetet e namazit? 66
129. Cili është dallimi ndërmjet shtyllave, obligimeve dhe suneteve të namazit? 67
130. Cila është forma e namazit? 68
131. Cilat janë ato gjëra që e prishin namazin? 74
132. Cilat janë dobitë dhe mirësitë e namazit? 75
13. Kapitulli i zekatit 76
133. Çfarë është zekati? 76
134. Cili është argumenti për obligueshmërinë e zekatit? 76
135. Cilat janë pasuritë për të cilat bëhet obligim zekati? 76
136. Cilat janë kushtet e obligueshmërisë së zekatit? 77
137. Cilët janë përfituesit e zekatit? 77
138. Cilat janë dobitë dhe mirësitë e zekatit? 78
14. Kapitulli i agjërimit 79
139. Çfarë është agjërimi? 79
140. Cili është argumenti për obligueshmërinë e agjërimit të muajit Ramazan? 79
141. Cila është urtësia e ligjësimit të agjërimit? 80

142. Cilat janë kushtet e obligueshmërisë së agjërimit? 80
143. Cilat janë arsyet që e lejojnë mosagjërimin gjatë ditës së Ramazanit? 80
144. Cilat janë gjërat që e prishin agjërimin? 81
145. Kur konsiderohet se e bëjnë të pavlefshëm agjërimin gjërat që e prishin atë? 81
146. Cilat janë gjërat që mund t'i bëjë agjëruesi dhe nuk konsiderohen prej prishësve të agjërimit? 81
147. Cilat janë veprat e pëlqyera gjatë agjërimit në Ramazan? 82
148. Cilat janë dobitë dhe urtësitë e agjërimit? 83
15. Kapitulli i haxhit 84
149. Çfarë është haxhi? 84
150. Cili është argumenti për obligueshmërinë e haxhit? 84
151. Cilat janë kushtet e obligueshmërisë së haxhit? 85
152. Cilat janë llojet e riteve të haxhit? 85
154. Cilat janë shtyllat e haxhit? 89
155. Cilat janë obligimet e haxhit? 89
156. Cilat janë sunetet e haxhit? 89
157: Cili është dallimi ndërmjet shtyllave, obligimeve dhe suneteve të haxhit? 90
158. Cilat janë ndalesat e ihramit për haxh ose umre? 90
159. Cili është gjykimi për atë që bën diçka prej ndalesave të ihramit? 91
160. Cilat janë dobitë e haxhit? 91

Parathënie e Shkëlqesisë së tij, ish-Myftiut të Përgjithshëm të Mbretërisë së Arabisë Saudite!

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit.

Falënderimi dhe lavdia i takojnë Allahut, Zotit të botëve. Mëshira dhe shpëtimi i Allahut qofshin për Profetin tonë Muhammedin, për familjen e tij dhe për të gjithë shokët e tij.

Më tej:

Kam lexuar librin "**Udhërrëfyes për njerëzit mbi bazat dhe çështjet kryesore të fesë Islame**", të shkruar nga Dr. Umer ibn AbduRrahman el-Umer. Megjithëse është një libër me përmasa të vogla, ai përfshin çështjet më të rëndësishme në kapitujt e teuhidit, akides së Ehli Sunetit dhe Xhematit, si dhe përmend shkurtimisht dispozitat e abdesit, namazit, zekatit, agjërimit dhe haxhit.

E kam vlerësuar si libër të dobishëm për përmbajtjen e tij, e cila është paraqitur në formë pyetjesh dhe përgjigjesh, me stil të thjeshtë, në mënyrë që leximi dhe kuptimi i tij të jenë të lehta për lexuesin.

Gjithashtu, është e pëlqyeshme që ky libër të përkthehet edhe në gjuhë të tjera, në mënyrë që të përfitojnë prej tij edhe ata që nuk flasin gjuhën arabe.

Salauatet dhe selamet e Allahut qofshin për Profetin tonë Muhammedin. Shpëtimi, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi ju.

Myftiu i Përgjithshëm i Mbretërisë së Arabisë Saudite,

Kryetar i Këshillit të Dijetarëve të Mëdhenj,

Kryetar i Përgjithshëm i Administratës së Kërkimeve Shkencore dhe Fetvave:

Abdulaziz ibn Abdil-Lah ibn Muhammed Al esh-Shejkh

Parathënie e Shkëlqesisë së Tij, Myftiut të Përgjithshëm të Mbretërisë së Arabisë Saudite

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit.

Falënderimi dhe lavdia i takojnë Allahut.

Më tej:

Kam lexuar një broshurë të Shejkhut Umer ibn AbduRrahman el-Umer, me titull: "Udhërrëfyes për njerëzit mbi bazat dhe çështjet kryesore të fesë Islame":

Ajo m'u duk e dobishme dhe cilësore, pavarësisht përmasave të vogla të saj.

Lus Allahun ta shpërblejë me të mira autorin dhe ta bëjë atë të dobishme për njerëzit.

Salauatet dhe selamet qofshin për Profetin tonë Muhammedin, familjen e tij dhe të gjithë shokët e tij.

Salih ibn Feuzan ibn Abdil-Lah el-Feuzan

10 Sefar 1437 hixhri.

Parathënie e Shkëlqesisë së Tij, Shejkh Salih bin Abdul'Aziz bin Muhammed Al esh-Shejkh, ish-Ministër i Çështjeve Islame, Thirrjes dhe Udhëzimit, Ministër i Shtetit dhe anëtar i Këshillit të Ministrave

Falënderimi dhe lavdia i takojnë Allahut, Zotit të botëve. Salauatet dhe selamet qofshin për më të nderuarin e Profetëve dhe të Dërguarve.

Më tej:

Kam lexuar librin "Udhërrëfyes për njerëzit mbi bazat dhe çështjet kryesore të fesë Islame", të autorit, shejkhut të nderuar Dr. Umer ibn AbduRrahman el-Umer. Ky libër, megjithëse me përmasa të vogla, m'u duk gjithëpërfshirës sa i përket çështjeve që i nevojiten muslimanit në akiden dhe adhurimet e tij.

Autori, Allahu i dhëntë sukses, ka bërë një zgjedhje të mirë dhe të larmishme të çështjeve. Po ashtu, ka treguar mjeshtëri në përmbledhjen dhe në argumentimin e tyre nga Kur'ani dhe Suneti, duke i paraqitur në formë pyetjesh dhe përgjigjesh.

Lus Allahun e Madhëruar ta shpërblejë autorin me të mira, t'ia pranojë përpjekjen dhe ta bëjë dijen e tij të dobishme për njerëzit.

Salauatet dhe selamet e Allahut qofshin për Profetin tonë Muhammedin, për familjen dhe të gjithë shokët e tij.

Ish-Ministri i Çështjeve Islame, Thirrjes dhe Udhëzimit,

Ministër i Shtetit dhe anëtar i Këshillit të Ministrave,

Salih bin Abdul'Aziz bin Muhammed Al esh-Shejkh

Parathënie e autorit

Falënderimi dhe lavdia i takojnë Allahut, i Cili na udhëzoi në teuhid (veçimin e Tij me adhurim) dhe në Sunet (pasimin me përpikëri të Profetit të Tij). Mëshira dhe shpëtimi qoftë për Profetin e udhëzimit dhe të mëshirës, Profetin tonë Muhammedin, si dhe për familjen dhe shokët e tij.

Mësimi i teuhidit, i besimit të saktë (akides) dhe i shtyllave të Islamit është ndër çështjet më të rëndësishme dhe ndër detyrimet më të domosdoshme, në mënyrë që akideja të jetë e saktë dhe adhurimi të jetë i ligjësuar, i sinqertë vetëm për Fytyrën e Allahut të Lartësuar dhe në përputhje me sheriatin e të Dërguarit të Tij, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

Për këtë arsye e shkrova këtë broshurë të shkurtër, në dritën e Kur'anit dhe Sunetit, si dhe duke u mbështetur në atë që kanë shkruar dijetarët e këtij umeti dhe imamët e thirrjes, si dhe në vepra të ndryshme të dobishme e të rëndësishme.

E titullova: *"Udhërrëfyes për njerëzit mbi bazat dhe çështjet kryesore të fesë Islame",* e ndava në kapituj dhe e përpilova në formë pyetjesh dhe përgjigjesh, që të jetë më i lehtë për t'u kuptuar dhe më afër arritjes së të vërtetës.

Lus Allahun e Lartësuar që ta bëjë këtë vepër të sinqertë vetëm për Fytyrën e Tij, në përputhje me kënaqësinë e Tij dhe të dobishme për robërit e Tij.

Salauatet dhe selamet e Allahut qofshin për Profetin tonë Muhammedin, për familjen dhe të gjithë shokët e tij.

1. Kapitulli i Tre Parimeve (el-usulu eth-thelatheh)

1. Cilat janë tre parimet që është detyrë për çdo musliman dhe muslimane t'i njohë?

Përgjigje: Tre parimet që është detyrë për çdo musliman dhe muslimane t'i njohë janë:

1. Ta njohë robi Zotin e tij.
2. Ta njohë robi fenë e tij.
3. Ta njohë robi Profetin e tij, Muhammedin, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

2. Kush është Zoti yt? Dhe cili është argumenti?

Përgjigje: Zoti im është Allahu, Ai i Cili është përkujdesur për mua, si dhe është përkujdesur për të gjitha krijesat me mirësitë e Tij. Ai është i Adhuruari im dhe unë nuk kam asnjë të adhuruar tjetër përveç Tij.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

"Falënderimi dhe lavdia i takojnë Allahut, Zotit të botëve." [El-Fatiḥah, 2]

3. Si e ke njohur Zotin tënd? Dhe cili është argumenti?

Përgjigje: E kam njohur Zotin tim përmes shenjave (ajeteve) të Tij dhe krijesave të Tij.

- Ndër shenjat e Tij janë: nata, dita, dielli dhe hëna.

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَمِنْ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ

"Dhe nga shenjat e Tij janë nata dhe dita, dielli dhe hëna." [Fussilet, 37]

• Ndër krijesat e Tij janë: shtatë qiejt, shtatë tokat, gjithçka që gjendet në to dhe gjithçka që është ndërmjet tyre.

Argumenti për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

اللَّهُ الَّذِى خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا فِى سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ

"Allahu është Ai që krijoi qiejt dhe tokën dhe gjithçka që gjendet ndërmjet tyre për gjashtë ditë, pastaj u lartësua mbi Arsh." [Es-Sexhdeh: 4]

4. Cila është feja jote? Dhe cili është argumenti?

Përgjigje: Feja ime është Islami.

Islami është: nënshtrimi ndaj Allahut me teuhid (veçimin e Tij me adhurim), bindja ndaj Tij me adhurime, dhe distancimi nga shirku dhe nga ithtarët e tij.

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَمَن يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَن يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِى الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ

"Kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, nuk do t'i pranohet kurrsesi, e ai në Botën tjetër do të jetë prej të humburve." [Al 'Imran: 85]

5. Cilat janë gradat e fesë?

Përgjigje: Gradat e fesë janë tri:

1. Islami [njeriu i vepron urdhëresat, por bie në ndalesa të mëdha].
2. Imani [njeriu i vepron urdhëresat, por bie në ndalesa të vogla].
3. Ihsani [përsosmëria në adhurim].

6. Kush është Profeti yt? Dhe cili është argumenti?

Përgjigje: Profeti im është Muhammedi, biri i AbduLlahut, biri i AbdulMuttalibit, biri i Hashimit. Hashimi është prej Kurejshëve, Kurejshët janë prej arabëve, ndërsa arabët janë prej pasardhësve të Ismailit, birit të Ibrahimit, i cili është miku i Allahut (khalilull-Llah). Mbi të dhe mbi Profetin tonë qofshin salauatet dhe selamet më të mira.

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

مَّا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّن رِّجَالِكُمْ وَلَٰكِن رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ

"Muhammedi nuk është babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve (i fundit i profetëve)." [El-Ahzab: 40]

2. Kapitulli: Shtyllat e Islamit dhe kuptimi i dy shehadeteve!

7. Cilat janë shtyllat e Islamit?

Përgjigje: Shtyllat e Islamit janë pesë:

1. Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut.
2. Falja e namazit.
3. Dhënia e zekatit.
4. Agjërimi i Ramazanit.
5. Kryerja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut (Qabe), për atë që ka mundësi.

8. Cili është kuptimi i dëshmisë: "La ilahe il-lAllah" dhe cili është argumenti për të?

Përgjigje: Fjala "La ilahe il-lAllah" domethënë: "Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut."

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

ذَٰلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْحَقُّ وَأَنَّ مَا يَدْعُونَ مِن دُونِهِ هُوَ الْبَاطِلُ وَأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْعَلِيُّ الْكَبِيرُ

"Kjo është kështu, sepse vetëm Allahu është i adhuruari i Vërtetë, ndërsa gjithçka që ata adhurojnë në vend të Tij është e pavërtetë (e kotë), dhe sepse Allahu është i Larti, i Madhi." [El-Haxhxh, 62]

9. Cilat janë shtyllat e dëshmisë "La ilahe il-lAllah" dhe cili është argumenti për to?

Përgjigje: Dëshmia "La ilahe il-lAllah" ka dy shtylla:

1. Mohimi i *tagutit* (çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut). Ky është mohimi që përfshihet në fjalën: "La ilahe" (Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë...).
2. Besimi në Allahun. Ky është pohimi që përfshihet në fjalën: "...il-lAllah" (...përveç Allahut).

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

فَمَن يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِن بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَى

"Kush mohon tagutin (çdo gjë tjetër që adhurohet përveç ose krahas Allahut) dhe beson në Allahun, ai është kapur pas lidhjes më të fortë." [El-Bekareh, 256][1]

Pra, fjala e Tij "Kush e mohon tagutin": është argument për mohimin, ndërsa fjala "dhe beson në Allahun": është argument për pohimin.

10. Cilat janë kushtet e fjalës "La ilahe il-lAllah"?

Përgjigje: Kushtet e "La ilahe il-lAllah" janë tetë:

1. Dituria *[el-'ilm],* e kundërta e injorancës.
2. Bindja e plotë *[el-jekin],* e kundërta e dyshimit.
3. Sinqeriteti *[el-ikhlas],* e kundërta e shirkut (syefaqësisë).
4. Vërtetësia *[es-sidk],* e kundërta e gënjeshtrës.
5. Dashuria *[el-mehabbeh],* e kundërta e urrejtjes.
6. Nënshtrimi *[el-inkijad],* e kundërta e braktisjes.
7. Pranimi *[el-kabul],* e kundërta e refuzimit.
8. Mohimi i gjithçkaje që adhurohet përveç Allahut.

Këto kushte janë përmbledhur në fjalët e një poeti:

"Dije, bindje, sinqeritet e vërtetësi,

Dashuri, nënshtrim e pranim me përkushtim gjithsesi.

Të tetën shtoje: çdo të adhuruar veç Allahut ta mohosh,

Që shehadetin ta plotësosh e Zotin Një me adhurim ta veçosh."

11. Çfarë është ajo që kërkohet nga dëshmia "La ilahe il-lAllah"?

Përgjigje: Dëshmia "La ilahe il-lAllah" përfshin dy çështje:

[1] Ka thënë Se'id ibn Xhubejr, Allahu e mëshiroftë: Me Fjalën e Allahut: "...lidhjen më të fortë", është për qëllim fjala "la ilahe il-lAllah". [Tefsirut-Taberij, 4/560]

1. Mohimin e tagutit, që do të thotë të mohosh çdo gjë që adhurohet përveç Allahut, të distancohesh nga shirku (politeizmi) dhe idhujtarët, si dhe nga kufri (mohimi, mosbesimi) dhe jobesimtarët. [Kjo është kërkesa e mohimit.]
2. Besimin në Allahun e Lartësuar, duke realizuar teuhidin e Tij (veçimin e Tij me adhurim) dhe duke ia kushtuar adhurimin me sinqeritet vetëm Atij. [Kjo është kërkesa e pohimit.]

12. Cili është kuptimi i dëshmisë "Muhammedi është i Dërguari i Allahut" [Muhammedun Resulull-Llah], dhe cili është argumenti për të?

Përgjigje: Kuptimi i dëshmisë "Muhammedi është i Dërguari i Allahut" është:

- Ta pohosh me gjuhë këtë dëshmi;
- Të besosh me zemër se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i Allahut për xhindët dhe njerëzit;
- Dhe se ai është vula e Profetëve dhe e të Dërguarve, pas të cilit nuk ka më Profet.

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا كَافَّةً لِلنَّاسِ بَشِيرًا وَنَذِيرًا

"Ne të kemi dërguar ty (o Muhammed) për mbarë njerëzit, si përgëzues dhe paralajmërues." [Sebe', 28]

13. Çfarë është ajo që kërkohet nga dëshmia se Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, është i Dërguari i Allahut?

Përgjigje: Ajo që kërkohet nga dëshmia se Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, është i Dërguari i Allahut:

1. T'i bindesh atij në çdo gjë që ka urdhëruar.
2. Ta besosh në gjithçka që ka njoftuar.
3. Ta braktisësh dhe të largohesh nga gjithçka që ai ka ndaluar dhe qortuar.
4. Të mos adhurohet Allahu ndryshe, veçse sipas asaj që ai ka ligjësuar.

3. Kapitulli: Shtyllat e imanit dhe frytet e tij

14. Cilat janë shtyllat e imanit?

Përgjigje: Shtyllat e imanit janë gjashtë:

1. Besimi në Allahun e Lartësuar.
2. Besimi në engjëjt (melaiket) e Tij.
3. Besimi në librat e Tij.
4. Besimi në të Dërguarit e Tij.
5. Besimi në Ditën e Gjykimit.
6. Besimi në kaderin (caktimin e Tij), qoftë i mirë apo i keq, se të gjitha janë të caktuara prej Allahut të Lartësuar.

15. Çfarë do të thotë besimi në Allahun e Lartësuar?

Përgjigje: Besimi në Allahun e Lartësuar përfshin katër çështje:

1. Besimi në ekzistencën e Allahut të Lartësuar.
2. Besimi në Rububijjen [veçimin e Allahut me veprat] e Tij.
3. Besimi në Uluhijjen e Tij [veçimin e Allahut me adhurim].
4. Besimi në Emrat dhe Cilësitë e Tij.

16. Cilat janë frytet e besimit në Allahun e Lartësuar?

Përgjigje: Frytet e besimit në Allahun e Lartësuar janë të shumta. Prej tyre janë:

1. Realizimi i teuhidit të Allahut të Lartësuar, duke ia kushtuar adhurimin vetëm Atij, pa i shoqëruar në adhurim askënd.
2. Plotësimi i dashurisë për Allahun e Lartësuar, frikës ndaj Tij dhe shpresës tek Ai, në përputhje me Emrat e Tij të bukur dhe Cilësitë e Tij të larta.
3. Realizimi i adhurimit të Tij duke zbatuar atë që Ai ka urdhëruar dhe duke braktisur dhe shmangur prej asaj që Ai ka ndaluar.

17. Çfarë do të thotë besimi në melaiket (engjëjt)?

Përgjigje: Besimi në engjëjt përfshin katër çështje:

1. Besimi në ekzistencën e tyre.
2. Besimi në ata engjëj emrat e të cilëve i dimë, [si p.sh. Xhibrili alejhis-selam], ndërsa për ata emrat e të cilëve nuk i dimë, besojmë në ta në mënyrë të përgjithshme.
3. Besimi në cilësitë e tyre për të cilat jemi njoftuar.
4. Besimi në veprat e tyre për të cilat jemi njoftuar.

18. Cilat janë frytet e besimit në engjëjt?

Përgjigje: Frytet e besimit në engjëjt janë të shumta, ndër to:

1. Njohja e madhështisë, fuqisë dhe pushtetit të Allahut të Lartësuar, sepse madhështia e krijesës tregon madhështinë e Krijuesit.
2. Falënderimi i Allahut të Lartësuar për kujdesin e Tij ndaj robërve besimtarë, pasi Ai ka caktuar engjëj që i mbrojnë ata.
3. Dashuria për engjëjt, për shkak të adhurimit të tyre ndaj Allahut të Lartësuar dhe afërsisë së tyre me robërit besimtarë.
4. Nxitja për të bërë vepra të mira dhe frikësimi nga veprat e këqija, ngaqë Allahu ka caktuar engjëj që regjistrojnë veprat e robërve, qofshin ato të mira apo të këqija.

19: Çfarë është besimi në Librat e shpallur?

Përgjigje: Besimi në Librat e shpallur përfshin katër çështje:

1. Të besohet se ato janë zbritur nga Allahu i Lartësuar dhe se janë realisht Fjala e Tij.
2. Të besohet në Librat emrat e të cilëve i dimë, si: Kur'ani, Teurati dhe Inxhili.
3. Të besohen lajmet e sakta që përmbajnë ato, si të gjitha lajmet e Kur'anit Fisnik dhe ato që janë përcjellë saktë nga librat e mëparshëm, të cilat Sheriati ynë i ka vërtetuar.
4. Të punohet sipas dispozitave të atij Libri që nuk është shfuqizuar. Duke e ditur se të gjithë Librat e mëparshëm janë shfuqizuar me shpalljen e Kur'anit. [Prandaj është detyrë të punohet vetëm me të].

20: Cilat janë frytet e besimit në Librat e shpallur?

Përgjigje: Frytet e besimit në Librat e shpallur janë të shumta, ndër to:

1. Njohja e mëshirës dhe përkujdesjes së Allahut ndaj robërve të Tij, pasi Ai ua shpalli Librat për t'i udhëzuar.
2. Njohja e urtësisë së Allahut në legjislacionin (sheriatin) e Tij, ngaqë Ai për secilin popull ka ligjësuar atë që i përshtatej gjendjes së tij, siç thotë Allahu i Lartësuar:

لِكُلٍّ جَعَلْنَا مِنكُمْ شِرْعَةً وَمِنْهَاجًا

"Për çdo popull kemi caktuar një ligj dhe një rrugë të përshtatshme." [El-Maideh, 48].

3. Falënderimi i Allahut të Lartësuar për këtë mirësi madhështore, për shpalljen e Librave të Tij.
4. Adhurimi i Allahut të Lartësuar me dije të qartë e të saktë, duke ndjekur Librin e shpallur dhe duke pasuar Profetin e dërguar.

21. Çfarë do të thotë besimi në të Dërguarit?

Përgjigje: Besimi në të Dërguarit përfshin katër çështje:

1. Të besohet në profetësinë e të gjithëve. Kush mohon qoftë edhe një të Dërguar, është sikur i ka mohuar që të gjithë.
2. Të besohet në ata të Dërguar emrat e të cilëve i dimë, si: Muhammedi, Nuhu, Ibrahimi, Musai dhe Isai, alejhimus-selam.
3. Të besohen si të vërteta të gjitha lajmet autentike që kanë sjellë ata.
4. Të veprohet sipas Sheriatit të atij që është dërguar te ne, e ai është Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, vula e profetëve dhe e të Dërguarve, i cili është dërguar për mbarë njerëzimin.

22. Cilat janë frytet e besimit në të Dërguarit?

Përgjigje: Frytet e besimit në të Dërguarit janë të shumta, ndër to:

1. Njohja e mëshirës dhe përkujdesjes së Allahut të Lartësuar ndaj robërve të Tij, pasi Ai u dërgoi atyre të Dërguar për t'i udhëzuar dhe për t'i thirrur në të mirën.

2. Adhurimi i Allahut me dije të saktë e të qartë, duke ndjekur Librin e shpallur dhe duke pasuar Profetin e dërguar.
3. Dashuria për të Dërguarit, *alejhimus-salatu ues-selam*, për shkak se ata e përcollën mesazhin hyjnor.
4. Falënderimi i Allahut të Lartësuar për këtë mirësi madhështore, dërgimin e të Dërguarve.

23. Çfarë është besimi në Ditën e Gjykimit?

Përgjigje: Me Ditën e Gjykimit nënkuptohet Dita e Ringjalljes (kijametit), në të cilën njerëzit do të ringjallen për t'u marrë në llogari dhe për t'u shpërblyer apo dënuar.

Besimi në Ditën e Gjykimit përfshin tri çështje:

1. Besimin në ringjalljen pas vdekjes.
2. Besimin në llogarinë dhe shpërblimin ose ndëshkimin.
3. Besimin në Xhennetin dhe Zjarrin (Xhehennemin).

Në besimin në Ditën e Gjykimit përfshihet gjithashtu besimi në çdo gjë që ndodh pas vdekjes, si:

- sprova e varrit,
- dënimi në varr, dhe
- shpërblimi në varr.

24. Cilat janë frytet e besimit në Ditën e Gjykimit?

Përgjigje: Frytet e besimit në Ditën e Gjykimit janë të shumta, ndër to:

1. Nxitja për të kryer urdhëresat e Allahut dhe për të shtuar veprat e mira, duke shpresuar për shpërblimin e asaj dite.
2. Largimi nga mëkatet dhe veprat e këqija, nga frika e dënimit të asaj dite.
3. Ngushëllimi i besimtarit për atë që i humbet nga kënaqësitë e kësaj bote, duke shpresuar në begatitë e përhershme të Akhiretit.

25. Çfarë është besimi në Kaderin, të mirën dhe të keqen e tij?

Përgjigje: Besimi në Kaderin, të mirën dhe të keqen e tij. Përfshin katër shkallë:

1. Besimi në Dijen e Allahut të Lartësuar; Ai i ka ditur të gjitha gjërat para se ato të ndodhnin.

[Dija e Allahut përfshin çdo gjë. Ai e di atë që ka ndodhur, atë që po ndodh dhe atë që do të ndodhë. Gjithashtu, Ai e di edhe atë që nuk ka ndodhur; dhe, sikur të kishte ndodhur, e di se si do të kishte ndodhur.]

2. Besimin se Allahu i Lartësuar i ka shkruar të gjitha ato që do të ndodhin në el-Leuh el-Mahfudh (Librin e Ruajtur).
3. Besimin se asgjë nuk ndodh përveçse me Vullnetin dhe Dëshirën e Allahut të Lartësuar.
4. Besimin se çdo gjë që ndodh është krijesë e Allahut të Lartësuar.

Këto katër shkallë të kaderit i ka përmbledhur një poet në fjalët e tij:

Dija, shkrimi
e vullneti i Tij,
Krijimi e formimi,
çdo gjë vjen prej Atij.

26. Cilat janë frytet e besimit në Kaderin, të mirën dhe të keqen e tij?

Përgjigje: Frytet e besimit në Kader janë të shumta, ndër to:

1. Sinqeriteti dhe vërtetësia në mbështetjen tek Allahu i Lartësuar dhe mbështetja tek Ai gjatë bërjes së përpjekjeve të duhura, sepse çfarë ka dashur Allahu ndodh, ndërsa çfarë nuk ka dashur Ai nuk ndodh.
2. Bindja e plotë se Allahu i Lartësuar është i Gjithëfuqishëm për të realizuar atë që dëshiron robi, edhe nëse të gjithë njerëzit bashkohen për ta penguar; dhe se Ai është i Fuqishëm ta largojë atë që robi i frikësohet, edhe nëse të gjithë njerëzit bashkohen për ta sjellë atë.
3. Durimi dhe kënaqësia me caktimin e Allahut kur njeriun e godasin fatkeqësi. Ai nuk zemërohet e nuk dëshpërohet, por thotë:
   "Kaderull-Llahi, ue ma shae fe'al"
   [Ky është caktimi i Allahut, dhe Ai bën çfarë të dojë].

4. Falënderimi i Allahut të Lartësuar për mirësitë e Tij dhe mosmahnitja me vetveten kur njeriu arrin atë që dëshiron, sepse kjo u arrit vetëm me Kaderin e Allahut të Lartësuar, suksesin dhe mirësinë e Allahut.
5. Udhëzimi i zemrës, dorëzimi i plotë ndaj Allahut dhe qetësia nga brengat dhe pikëllimi, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar:

مَا أَصَابَ مِن مُّصِيبَةٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ۗ وَمَن يُؤْمِن بِاللَّهِ يَهْدِ قَلْبَهُ ۚ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

"Çdo fatkeqësi që ju bie, ndodh veçse me lejen e Allahut. E kush beson në Allahun, Ai ia udhëzon zemrën. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë." [Et-Tegabun, 11]

6. Shpëtimi nga smira (haseti), sepse smirëkeqi, me dëshirën që tjetrit t'i hiqet mirësia që Allahu ia ka caktuar, në realitet po kundërshton Caktimin dhe Kaderin e Allahut.

4. Kapitulli: Ihsani dhe frytet e tij

27. Çfarë është ihsani?

Përgjigje: Ihsani është ta adhurosh Allahun sikur po e sheh Atë. Edhe pse nuk e sheh Atë, e di se Ai të sheh ty.

28. Cilat janë gradat e ihsanit?

Përgjigje: Ihsani ka dy grada:

1. Grada e parë: Shikimi me zemër, e cila është grada më e lartë. Ajo është që robi ta adhurojë Zotin e tij sikur po e sheh Atë.
2. Grada e dytë: Mbikëqyrja, e cila është që robi ta dijë se Allahu e sheh në çdo vend; Atij nuk i fshihet asgjë.

Siç thotë i Lartësuari:

يَعْلَمُ خَائِنَةَ الْأَعْيُنِ وَمَا تُخْفِي الصُّدُورُ

"Ai e di shikimin e fshehtë të syve, di dhe atë që fshehin kraharorët." [Gafir, 19]

29. Cilat janë frytet e ihsanit?

Përgjigje: Frytet e ihsanit janë të shumta. Prej tyre janë:

1. Frika ndaj Allahut të Lartësuar në fshehtësi dhe haptazi, si edhe në vetmi dhe para njerëzve.
2. Sinqeriteti në adhurimin e Allahut të Lartësuar, duke bërë përpjekje për ta përmirësuar dhe përsosur adhurimin.
3. Allahu është me ata që e realizojnë ihsanin dhe i do ata.
4. Fitimi i Xhennetit dhe shikimi i Allahut të Lartësuar.

5. Kapitulli: Teuhidi dhe virtytet e tij

30. Çfarë është teuhidi? Cilat janë llojet e tij?

Përgjigje: Teuhidi është veçimi i Allahut të Lartësuar me atë që i përket vetëm Atij.

Ai ndahet në tri lloje:

1. Teuhidi *Rububijjeh* [veçimi i Allahut në veprat e Tij].
2. Teuhidi *Uluhijjeh* [veçimi i Allahut në adhurim].
3. Teuhidi i Emrave dhe Cilësive [veçimi i Allahut në Emrat dhe Cilësitë e Tij].

31. Çfarë është Teuhidi Rububijjeh?

Përgjigje: Teuhidi Rububijjeh është veçimi i Allahut të Lartësuar në veprat e Tij.

Është thënë gjithashtu: Teuhidi Rububijjeh është veçimi i Allahut të Lartësuar si i Vetmi në krijim, në sundim, dhe në rregullimin dhe sistemimin e të gjitha çështjeve.

32. A mjafton Teuhidi Rububijjeh për të hyrë në Islam?

Përgjigje: Jo, Teuhidi Rububijjeh nuk mjafton për të hyrë në Islam. Kjo sepse idhujtarët, politeistët në kohën e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, e pranonin Rububijjen, pra besonin se nuk ka krijues tjetër përveç Allahut, por vetëm kjo nuk u bëri dobi.

Argumenti është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَلَئِن سَأَلْتَهُم مَّنْ خَلَقَهُمْ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ ۖ فَأَنَّىٰ يُؤْفَكُونَ

"Dhe, nëse i pyet ata se kush i krijoi, me siguri do të thonë: Allahu! Atëherë si po largohen (nga veçimi i Tij me adhurim)?!" [Ez-Zukhruf, 87]

33. Cila është rëndësia e Teuhidit Rububijjeh?

Përgjigje: Rëndësia e Teuhidit Rububijjeh përmblidhet në këto çështje:

1. Teuhidi Rububijjeh e kërkon domosdoshmërisht Teuhidin Uluhijjeh dhe është argument që të çon drejt adhurimit të Allahut të Vetëm, pa ortak.

2. Teuhidi Rububijjeh përfshin besimin në kaderin (caktimin e Allahut), sepse kaderi është prej veprave të Allahut të Lartësuar. Prandaj, kush e mohon kaderin, nuk e ka besuar Teuhidin Rububijjeh.
3. Nga frytet e Teuhidit Rububijjeh është mbështetja (teuekkuli) tek Allahu, i cili është një nga gradat më të larta të fesë dhe prej pozitave më të larta të besimtarëve.
4. Teuhidi Rububijjeh i mbron muslimanët nga rreziku i ateizmit dhe dyshimet e ateistëve.

34. Çfarë është Teuhidi Uluhijjeh?

Përgjigje: Teuhidi Uluhijjeh është veçimi i Allahut me veprat e robërve.

Është thënë gjithashtu: Teuhidi Uluhijjeh është veçimi i Allahut me adhurim.

35. Cila është rëndësia e Teuhidit të Uluhijjeh?

Përgjigje: Teuhidi Uluhijjeh është lloji më i rëndësishëm teuhidit për këto arsye:

1. Teuhidi Uluhijjeh është kuptimi i dëshmisë "La ilahe il-lAllah" [Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut].
2. Teuhidi Uluhijjeh është qëllimi për të cilin Allahu krijoi xhindët dhe njerëzit.
3. Teuhidi Uluhijjeh ishte thirrja e të gjithë Profetëve dhe të Dërguarve, dhe për shkak të tij lindi konflikti ndërmjet tyre dhe popujve të tyre.
4. Teuhidi Uluhijjeh është e drejta e Allahut mbi robërit e Tij.
5. Teuhidi Uluhijjeh është themeli i vlefshmërisë së veprave dhe i pranimit të adhurimeve.

36. Çfarë është Teuhidi i Emrave dhe Cilësive?

Përgjigje: Teuhidi i Emrave dhe Cilësive është veçimi i Allahut, të Pastër prej të metave e të Lartësuar, me Emrat me të Cilët Ai e ka emërtuar Veten dhe me Cilësitë me të Cilat Ai e ka cilësuar Veten në Librin e Tij, ose me të cilat e ka quajtur dhe cilësuar i Dërguari i Tij, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

Kjo arrihet:

- duke pohuar çdo gjë që Allahu e ka pohuar për Veten e Tij;
- duke mohuar çdo gjë që Allahu e ka mohuar për Veten e Tij;
- pa shtrembëruar kuptimet e tyre, pa mohuar asgjë prej tyre, pa krahasuar, pa shembëllyer e pa përngjasuar.

37. Cila është metodologjia e Ehli Sunetit dhe Xhematit në Teuhidin e Emrave dhe Cilësive?

Përgjigje: Metodologjia e Ehli Sunetit dhe Xhematit në Teuhidin e Emrave dhe Cilësive përfshin dy parime themelore:

1. Ata (Ehli Suneti) pohojnë ata Emra dhe Cilësi që Allahu ka pohuar për Veten e Tij në Librin e Tij, ose që i ka pohuar lidhur me Të i Dërguari i Tij, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, pa përngjasim me krijesat.
2. Ata mohojnë çdo gjë që Allahu ka mohuar për Veten e Tij në Librin e Tij, ose që i ka mohuar lidhur me Të i Dërguari i Tij, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, duke e pastruar dhe lartësuar Allahun prej çdo mangësie, pa mohuar asgjë prej Cilësive të Tij.

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ۖ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ

"Asgjë nuk është e ngjashme me Të, dhe Ai është Dëgjuesi, Shikuesi." [Esh-Shuura, 11]

Fjala e Tij "Asgjë nuk është e ngjashme me Të"; refuzon përngjasimin dhe shembëllimin me Allahun.

Fjala e Tij "...dhe Ai është Dëgjuesi, Shikuesi"; refuzon mohimin e Emrave dhe Cilësive të Tij.

38. Cila është rëndësia e Teuhidit të Emrave dhe Cilësive?

Përgjigje: Besimtari e ka obligim t'i kushtojë rëndësi Teuhidit të Emrave dhe Cilësive për këto arsye:

1. Dija për Emrat dhe Cilësitë e Allahut është më fisnikja prej të gjitha dijeve, sepse fisnikëria e një dijeje matet me fisnikërinë e temës që ajo studion.
2. Dija për Emrat dhe Cilësitë e Allahut është rruga për ta njohur Allahun e Lartësuar.
3. Shton besimin në Allahun e Lartësuar. Sa më shumë që robi njeh Emrat dhe Cilësitë e Allahut, aq më shumë i shtohet besimi dhe i forcohet bindja.
4. Forcon veprat e zemrës, si:
    - dashurinë ndaj Allahut të Lartësuar,
    - frikën prej Tij,
    - shpresën tek Ai.

5. Emrat dhe Cilësitë e Allahut përfshijnë të tri llojet e Teuhidit.
6. Mbrojnë nga devijimet, si: përngjasimi i Allahut me krijesat, si dhe mohimi i Emrave dhe Cilësive të Tij. Këto devijime i kanë disa sekte, si Xhehmijet, Mu'tezilitë dhe Esh'aritë.

39. Cilat janë virtytet e Teuhidit?

Përgjigje: Virtytet e Teuhidit janë të shumta. Prej tyre janë:

1. Mbrojtja e gjakut dhe e pasurisë.
2. Largimi i brengave dhe vështirësive të dynjasë dhe të Akhiretit.
3. Fitorja ndaj armiqëve dhe fuqizimi në tokë.
4. Udhëzimi i plotë dhe siguria e plotë në këtë botë dhe në Botën tjetër.
5. Jeta e lumtur në këtë botë dhe shpërblimi i madh në Akhiret.
6. Shlyerja e gjynaheve dhe e mëkateve.
7. Fitimi i ndërmjetësimit (shefatit) të Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.
8. Çlirimi nga robëria ndaj krijesave, nga varësia prej tyre, frika prej tyre ose shpresa tek ata.
9. Shpëtimi nga Zjarri i Xhehennemit.
10. Hyrja në Xhennet.

6. Kapitulli: Rriddeja [Dalja nga Islami]

40. Çfarë është Rriddeh dhe cili është argumenti për të?

Përgjigje: Rriddeh është mosbesimi pas Islamit. [Braktisja e fesë Islame pas të qenurit musliman]

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَمَن يَرْتَدِدْ مِنكُمْ عَن دِينِهِ فَيَمُتْ وَهُوَ كَافِرٌ فَأُولَٰئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ ۖ وَأُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ

"Kush prej jush largohet nga feja Islame dhe vdes duke qenë jobesimtar, atyre u zhduken të gjitha veprat në këtë botë dhe në Botën tjetër. Ata janë banorë të Zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përgjithmonë." [El-Bekareh, 217]

41. Cilat janë llojet e Rriddesë?

Përgjigje: Rriddeja ndahet në pesë lloje:

1. Rriddeh me fjalë. [Duke thënë fjalë që e nxjerrin njeriun nga Islami.]
2. Rriddeh me vepra. [Duke kryer vepra që përbëjnë kufër apo shirk.]
3. Rriddeh me bindje (akideh). [Duke mbajtur në zemër besime që ta anulojnë Islamin.]
4. Rriddeh me dyshim. [Duke dyshuar në fenë Islame, në Kur'an apo në udhëzimin e Profetit.]
5. Rriddeh me braktisje. [Duke braktisur Fenë dhe veprimin me të.]

42. Cilat janë shembujt e Rriddesë me fjalë?

Përgjigje: Rriddeja me fjalë ndodh me disa mënyra, prej tyre:

1. Sharja e Allahut të Lartësuar ose e të Dërguarit të Tij, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.
2. Tallja me Allahun, me ajetet (argumentet) e Tij, me të Dërguarin e Tij, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, ose me shenjat e dukshme të fesë.
3. Pretendimi i dijes së gajbit [të pretendosh se di të fshehtën, apo të ardhmen].
4. Pretendimi i profetësisë.

5. Lutja drejtuar dikujt tjetër përveç Allahut në çështje që nuk ka fuqi t'i bëjë askush përveç Allahut [si kërkimi i ndihmës në gjëra të mbinatyrshme, falja e mëkateve, largimi i fatkeqësive ose plotësimi i nevojave që janë vetëm në dorën e Allahut].

43. Cilët janë shembujt e Rriddesë me vepra?

Përgjigje: Rriddeja me vepra ndodh me disa mënyra, prej tyre:

1. Bërja sexhdeh dikujt tjetër përveç Allahut, si për shembull t'i biesh në sexhdeh një idhulli ose një varri.
2. Therja e kurbanit për xhindët, duke shpresuar përfitim ose nga frika prej tyre, ose kurbani për të vdekurit si afrim tek ata.
3. Hedhja e Mus'hafit (Kur'anit) në vende të papastra [në formë përçmimi].
4. Praktikimi i magjisë (sihrit), mësimi i saj dhe mësimdhënia e saj.
5. Mbështetja dhe përkrahja e idhujtarëve (mushrikëve), t'i marrësh për miq ata, apo t'i duash; me qëllimin e ndihmës apo triumfit të fesë së tyre [duke pasur qëllim të triumfojë mosbesimi, ose çdo fe përveç Islamit].

44. Cilat janë shembujt e Rriddesë në akide (besim)?

Përgjigje: Rriddeja në akide ndodh me disa mënyra, prej tyre:

1. Të besosh se Allahu ka ortak në Rububijjeh, në Uluhijjeh ose në Emrat dhe Cilësitë e Tij.
2. Të besosh se nuk ka ringjallje pas vdekjes, ose se nuk ekzistojnë Xhenneti dhe Zjarri.
3. Të konsiderosh të lejuar atë që Allahu e ka ndaluar, si zinaja (marrëdhëniet jashtëmartesore) ose pirja e alkoolit. Apo të besosh se lejohet gjykimi me ligje të tjera përveç atyre që ka zbritur Allahu, apo se ligjet e vendosura nga njerëzit janë më të mira se gjykimi i Allahut.
4. Të besosh se fetë e pavërteta janë të sakta, si hebraizmi, krishterimi ose budizmi.

45. Cilët janë shembujt e Rriddesë me dyshim?

Përgjigje: Rriddeja me dyshim ndodh me disa mënyra, prej tyre:

1. Dyshimi në ringjalljen pas vdekjes, ose në ekzistencën e Xhennetit dhe Zjarrit.
2. Dyshimi në fenë Islame, ose në përshtatshmërinë dhe vlefshmërinë e saj për këtë kohë.
3. Dyshimi në profetësinë e Profetit Muhamned, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, ose në vërtetësinë e tij.
4. Dyshimi në Kur'anin Fisnik, se ai është Fjala e Allahut të Lartësuar.

46. Cili është shembulli i Rriddesë me braktisje (lënie)?

Përgjigje: Rriddeja me lënie është lënia e namazit me qëllim, sipas mendimit më të saktë prej mendimeve të dijetarëve, bazuar në fjalën e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

إنّ بينَ الرجلِ وبينَ الشركِ والكفرِ تركُ الصلاةِ

"Me të vërtetë, ndërmjet njeriut dhe shirkut (politeizmit) e kufrit (mosbesimit) është lënia e namazit." [Transmeton Muslim, 82]

[Shënim i përkthyesit: Ka mospajtime te dijetarët për atë njeri që nuk e fal namazin por e pohon obligueshmërinë e tij: Disa prej tyre e shpallin si mosbesimtar e disa e shpallin si mëkatar të madh.

Ndërsa sa u përket shembujve të përmendur në tekst, në kapitullin e Rriddesë, themi se gjykimi me Riddeh mbi një person të caktuar, i cili pretendon se është musliman, por bie në njërin nga anuluesit të Islamit, obligon që të jenë plotësuar kushtet dhe larguar pengesat. Kjo është çështje që u takon dijetarëve dhe njerëzve kompetentë, e jo individëve]

7. Kapitulli: Shirku në adhurim

47. Çfarë është shirku? Cilat janë llojet e shirkut në adhurim?

Përgjigje: Shirku është t'i bësh Allahut të Lartësuar ortak në adhurim, duke i shoqëruar dikë tjetër me Të.

Shirku në adhurim ndahet në dy lloje:

1. Shirku i madh.
2. Shirku i vogël.

48. Çfarë është shirku i madh?

Përgjigje: Shirku i madh është t'i kushtosh dikujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar ndonjë prej llojeve të adhurimit.

49. Përmend disa shembuj të shirkut të madh.

Përgjigje: Shirku i madh ka shumë shembuj. Prej tyre:

1. Kërkimi nga të vdekurit që t'i plotësojë ndonjë nevojë dhe kërkimi i ndihmës prej tyre.
2. Therja e kurbanit për dikë tjetër përveç Allahut, si psh. për varret, xhindët ose shejtanët.
3. Kërkimi i ndihmës nga njerëzit e mirë e të devotshëm (eulijatë) në gjëra që nuk ka mundësi t'i bëjë askush përveç Allahut, si plotësimi i nevojave apo largimi i fatkeqësive dhe vështirësive.

50. Cilat janë pasojat e shirkut të madh?

Përgjigje: Shirku i madh është shumë i rrezikshëm dhe ka pasoja të shumta. Prej tyre janë:

1. Shirku i madh është mëkati më i madh, padrejtësia më e madhe dhe gjynahu më i rëndë.
2. Shirku i madh e nxjerr njeriun nga Islami.
3. Shirku i madh i shkatërron (i asgjëson) të gjitha veprat e mira.
4. Allahu i Lartësuar nuk ia fal atij që vdes duke qenë në shirk të madh.
5. Shirku i madh e pengon hyrjen në Xhennet dhe ai që vdes me të do të qëndrojë përgjithmonë në Zjarr.

51. Cilat janë shkaqet e rënies në shirkun e madh?

Përgjigje: Shkaqet e rënies në shirkun e madh janë të shumta. Ndër më të rëndësishmet janë:

1. Teprimi në madhërimin e njerëzve të devotshëm.
2. Padituria rreth realitetit të Teuhidit dhe kuptimit të saktë të dëshmisë: "La ilahe il-lAllah" [Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut].
3. Ndjekja e epsheve.
4. Pasimi i verbër i paraardhësve dhe i thirrësve në të keqe.

52. Çfarë është shirku i vogël?

Përgjigje: Shirku i vogël është çdo gjë që Sheriati e ka ndaluar, e cila është mjet që çon drejt shirkut të madh dhe që në tekstet fetare është quajtur shirk.

53. Përmend llojet e shirkut të vogël.

Përgjigje: Shirku i vogël ndahet në dy lloje:

- Lloji i parë:

Shirku i dukshëm, i cili është dy llojesh:

1. Shirk me fjalë, si:
   - betimi në dikë tjetër përveç Allahut;
   - të thuhet: "U bë çfarë deshi Allahu dhe ti."

2. Shirk me vepra, si:
   - mbajtja e ndonjë byzylyku, unaze, peri ose gjëje të ngjashme me to, me qëllim që të largimit ose parandalimit të fatkeqësisë.

Si dhe varja e hajmalive dhe nuskave nga frika e mësyshit ose e dëmeve të tjera.

- Lloji i dytë:

Shirku i fshehtë, i cili është syefaqësia (rijaja) në adhurim.

54. Cili është dallimi ndërmjet shirkut të madh dhe shirkut të vogël?

Përgjigje: Dallimi ndërmjet shirkut të madh dhe shirkut të vogël është në çështjet vijuese:

1. Shirku i madh e nxjerr njeriun nga Islami, ndërsa shirku i vogël nuk e nxjerr nga Islami, por ia dobëson Teuhidin.
2. Shirku i madh bie ndesh me bazat e Teuhidit, ndërsa shirku i vogël bie ndesh me përsosmërinë e detyrueshme të Teuhidit.
3. Shirku i madh i asgjëson të gjitha veprat e mira, ndërsa shirku i vogël nuk i asgjëson të gjitha veprat. Për shembull, rijaja (syefaqësia) e asgjëson vetëm veprën me të cilën është shoqëruar ajo.
4. Shirku i madh e bën njeriun të qëndrojë përgjithmonë në Zjarr, ndërsa shirku i vogël nuk e bën atë të qëndrojë përgjithmonë në Zjarr, nëse hyn në të.

8. Kapitulli: Nifaku [hipokrizia]

55. Çfarë është nifaku? Cilat janë llojet e tij?

Përgjigje: Nifaku (hipokrizia) është shfaqja e së mirës dhe fshehja e së keqes.

Ai ndahet në dy lloje:

1. Hipokrizia në besim, e cila quhet dhe nifak i madh.
2. Hipokrizia në vepra, e cila quhet nifak i vogël.

56. Çfarë është nifaku në besim?

Përgjigje: Nifaku në besim është shfaqja e Islamit dhe fshehja e kufrit (mosbesimit).

57. Cilat janë llojet e nifakut në besim?

Përgjigje: Nifaku në besim është gjashtë llojesh. Ato janë:

1. Përgënjeshtrimi i të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.
2. Përgënjeshtrimi i një pjese të asaj që ka sjellë i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.
3. Urrejtja ndaj të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.
4. Urrejtja ndaj ndonjë pjese të asaj që ka sjellë i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.
5. Gëzimi për dobësimin e fesë së të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.
6. Urrejtja për fitoren dhe triumfin e fesë së të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

58. Çfarë është nifaku në vepra?

Përgjigje: Nifaku në vepra është bërja e ndonjë vepre të hipokritëve, ndërkohë që baza e besimit mbetet në zemër: si për shembull gënjeshtra, tradhtia dhe dembelizmi ndaj faljes së namazit me xhemat.

59. Cili është dallimi ndërmjet nifakut në besim dhe nifakut në vepra?

Përgjigje: Dallimi ndërmjet nifakut në besim dhe nifakut në vepra është në këto çështje:

1. Nifaku në besim e nxjerr njeriun nga Islami, ndërsa nifaku në vepra nuk e nxjerr nga Islami.
2. Nifaku në besim është mospërputhja ndërmjet asaj që njeriu fsheh në zemër dhe asaj që shfaq në pamjen e jashtme në çështjet e besimit.

Ndërsa nifaku në vepra është mospërputhja ndërmjet asaj që fsheh në zemër dhe asaj që shfaq në pamjen e jashtme në veprat e tij.

3. Nifaku në besim nuk mund të gjendet te një besimtar, ndërsa nifaku në vepra mund të shfaqet edhe te një besimtar.

9. Kapitulli: Adhurimi i ligjësuar dhe bidatet (shpikjet) e ndaluara!

60. Përse na ka krijuar Allahu i Lartësuar? Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Allahu i Lartësuar na ka krijuar që ta adhurojmë vetëm Atë, pa i shoqëruar ortak.

Argumenti për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

"Unë nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit për gjë tjetër, përveçse që të Më adhurojnë vetëm Mua." [Edh-Dharijat, 56]

61. Çfarë është adhurimi?

Përgjigje: Adhurimi është një emër përmbledhës që përfshin çdo fjalë dhe vepër, të dukshme dhe të fshehtë, që Allahu e do dhe është i kënaqur me to.

62. Cilat janë kushtet për pranimin e adhurimit?

Përgjigje: Adhurimi, që të jetë i pranuar, duhet të plotësojë dy kushte:

1. Sinqeriteti (ikhlasi) vetëm për Allahun e Lartësuar.
2. Pasimi i të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

63. Çfarë është sinqeriteti (ikhlasi) për Allahun e Lartësuar?

Përgjigje: Ikhlasi është pastrimi i adhurimit nga çdo lloj shirku, syefaqësie (rijaje) dhe dëshire për t'u dëgjuar e lavdëruar nga njerëzit (sum'ah).

64. Cili është argumenti për obligueshmërinë e ikhlasit ndaj Allahut të Lartësuar?

Përgjigje: Argumenti për obligueshmërinë e ikhlasit është fjala e Allahut të Lartësuar:

وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ

"E ata nuk u urdhëruan për tjetër, përveçse ta adhurojnë Allahun me ikhlas (sinqeritet) të plotë ndaj Tij, duke e realizuar Fenë vetëm për Të." [El-Bejjineh, 5]

65. Çfarë është pasimi i të Dërguarit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*?

Përgjigje: Pasimi i të Dërguarit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, është marrja e tij si shembull dhe ndjekja me përpikëri në adhurimin e Allahut të Lartësuar.

Ky pasim nuk realizohet ndryshe, veçse kur adhurimi përputhet me atë me të cilën ka ardhur i Dërguari, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, në gjashtë çështje:

1. Në shkakun e saj.
2. Në llojin e saj.
3. Në masën e saj.
4. Në mënyrën (formën) e saj.
5. Në kohën e saj.
6. Në vendin e saj.

66. Cili është argumenti për obligueshmërinë e pasimit të të Dërguarit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*?

Përgjigje: Argumenti për obligueshmërinë e pasimit të të Dërguarit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, është Fjala e Allahut të Lartësuar:

قُلْ إِن كُنتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ۗ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ

"Thuaj (o Muhammed): Nëse vërtet e doni Allahun, atëherë më pasoni mua; në këtë mënyrë Allahu do t'ju dojë juve dhe do t'ju falë mëkatet tuaja. Pa dyshim se Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirues." [Al 'Imran, 31]

67. Çfarë është bidati në fe?

Përgjigje: Bidati është çdo gjë e shpikur në fe pa ndonjë argument nga Kurani ose Suneti, sipas kuptimit të brezave të parë të këtij umeti.

68. Cili është gjykimi i bidatit në fe? Përmendni argumentin.

Përgjigje: Çdo bidat në fe është i ndaluar dhe është devijim.

Argumenti për këtë është fjala e të Dërguarit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

من أحدث فى أمرِنا هذا ما ليس منه فهو رَدٌّ

"Kush shpik në Fenë tonë diçka që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar." [Transmeton el-Bukharij (2697), Muslim (1718)]

Dhe fjala e tij, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

وكلّ بدعة ضلالة

"Çdo bidat është humbje dhe devijim." [Transmeton Muslim, 867]

69. Cilat janë llojet e bidateve në fe?

Përgjigje: Bidatet në fe janë dy lloje:

1. Lloji i parë: Bidati në fjalë dhe në besim (akideh).

Ky është bidati që lidhet me bindjet dhe akiden, siç janë thëniet e Xhehmive, Mu'tezilëve, Khauarixhve, Rrafidive (shijave) dhe të gjitha grupeve të devijuara, si dhe bindjet e tyre.

Ky lloj bidati është më i rrezikshmi nga të gjitha llojet e bidateve.

2. Lloji i dytë: Bidati në adhurime.

Ky ndahet në dy kategori:

1. Bidati i vërtetë, real. Bidat i vërtetë është çfarëdo adhurimi i shpikur, i cili nuk ka asnjë bazë në Sheriat, si për shembull: festimi i Mevludit të Profetit (ditëlindjes së tij).
2. Bidati i shtuar. Bidat i shtuar është çfarëdo adhurimi i shpikur që i bashkëngjitet një baze të ligjësuar, por duke ndryshuar mënyrën e saj, si:
    - dhikri në grup (me xhemat);
    - shtimi në sasinë e një adhurimi, si shtimi i një rekati të pestë në namazin e drekës;
    - përcaktimi i një kohe të veçantë për një adhurim, për të cilën Sheriati nuk e ka përcaktuar, si agjërimi i ditës së mesit të muajit Shaban.

70. Përmend shembuj të bidatit në fe.

Përgjigje: Bidatet në fe janë të shumta. Ndër më të njohurat janë:

1. Bidati i festimit të Mevludit të Profetit.
2. Bidati i festimit të natës së Israsë dhe Miraxhit.
3. Bidati i ndërtimit mbi varre, marrja e tyre si vend adhurimi dhe udhëtimi drejt tyre (me qëllim adhurimi).

71. Cilat janë shkaqet e rënies në bidate?

Përgjigje: Rënia në bidate ka disa shkaqe. Prej tyre janë:

1. Padituria dhe injoranca rreth Sunetit të saktë.
2. Braktisja e praktikës së sahabëve dhe e kuptimit të tyre ndaj teksteve të Kur'anit dhe Sunetit.
3. Ndjekja e epsheve (ëndjeve).
4. Pasimi i verbër i paraardhësve dhe i thirrësve në devijim.
5. Përngjasimi me jobesimtarët.

10. Kapitull përmbledhës rreth akides së Ehli Sunetit dhe Xhematit

72. Cili është grupi i shpëtuar prej Zjarrit, nga grupet e muslimanëve?

Përgjigje: Grupi i shpëtuar prej Zjarrit është grupi i pasuesve të sunetit dhe xhematit.

73. Kush janë pasuesit e sunetit dhe xhematit?

Përgjigje: Pasuesit e sunetit dhe xhematit janë ata të cilët janë bashkuar në kapjen pas sunetit të Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe në zbatimin e tij, si nga ana e jashtme ashtu dhe nga ana e brendshme, qoftë në fjalë, në vepra apo edhe në akide. Pikërisht për këtë quhen edhe me emrin "pasuesit e hadithit".

Është thënë gjithashtu:

Pasuesit e Sunetit dhe Xhematit janë pasuesit e rrugës së drejtë, të cilët ndjekin me përpikëri Islamin e saktë me të cilin erdhi Muhammedi, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*. Këtë rrugë e ndoqën edhe *selefët* e devotshëm; prandaj ajo quhet edhe me emrin Selefije.

74. Cili është shkaku i emërtimit të tyre me emrin Pasuesit e Sunetit dhe Xhematit?

Përgjigje: Shkaku i emërtimit të tyre me emrin Pasuesit e Sunetit është se ata ndjekin Sunetin e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

Ndërsa quhen Pasuesit e Xhematit, sepse janë të bashkuar në pasimin e Sunetit.

75. Cili është shkaku i emërimit të tyre me Selefije?

Përgjigje: Shkaku i emërimit të tyre me emrin Selefije është se ata ndoqën me përpikëri metodologjinë e selefëve (të parëve) të devotshëm; të sahabëve - Allahu qoftë i kënaqur me ta – dhe të tabi'inëve.[2]

[2] Nuk është aspak prej metodologjisë selefije që dikush ta quajë veten "selefi xhihadist". Metodologjia e njerëzve të tillë bazohet në ekstremizëm, në tekfir, në xhihad të shpikur (bidat), në bërjen të lejuar të derdhjes së gjakut të njerëzve të paprekshëm (të mbrojtur në Islam) dhe në ngritjen kundër udhëheqësve të muslimanëve. Ndërkaq, Selefët e devotshëm janë të pastër prej tyre dhe të distancuar nga veprat e tyre.

76. Cili është argumenti se pasuesit e sunetit dhe xhematit janë grupi i shpëtuar?

Përgjigje: Argumenti se Pasuesit e Sunetit dhe Xhematit janë grupi i shpëtuar është hadithi i saktë dhe i njohur për ndarjen e umetit në grupe, në të cilin Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, thotë:

افترقتِ اليهودُ على إحدَى وسبعينَ فرقةً۞ وافترقتِ النصارَى على ثنتَينِ وسبعينَ فرقةً۞ وستفترقُ هذه الأمةُ على ثلاثٍ وسبعينَ فرقةً كلُّها فى النارِ إلا واحدةً۞ قيل: من هم يا رسولَ اللهِ۞ قال: مَا أنا عليه اليوم وأصحابِى. و فى لفظ: الجماعة

"Jehudët u ndanë në shtatëdhjetë e një grupe, të krishterët u ndanë në shtatëdhjetë e dy grupe, ndërsa ky umet do të ndahet në shtatëdhjetë e tri grupe. Të gjitha do të jenë në Zjarr, përveç njërit grup."[3]

I thanë: Kush janë ata, o i Dërguari i Allahut?

Tha: "Ata që ndjekin rrugën në të cilën jam unë sot dhe shokët e mi."

Ndërsa në një transmetim tjetër ka thënë: "Ata janë pasuesit e xhematit."

77. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit lidhur me pohimin e Cilësisë së Allahut se Ai qëndron mbi krijesat e Tij (el-'ulu), si dhe Cilësisë së Tij të lartësimit (istiuasë)?

Përgjigje: Besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me pohimin e Cilësisë së qëndrimit të Allahut mbi krijesat e Tij (el-'ulu), si dhe Cilësisë së lartësimit të Tij (istiuasë), është qëndrimi për të cilin kanë rënë në unanimitet të gjithë sahabët dhe të gjithë Profetët, *alejhimus-selam*. Ky besim është se Allahu, i Pastër prej të metave e i Lartësuar, është lart, mbi shtatë qiejt, i Lartësuar mbi Arshin (Fronin) e Tij, i ndarë prej krijesave të Tij.

[3] Transmeton et-Tirmidhij (2641), Ebu Daud (4596), Ibn Maxheh (3992), e ka saktësuar Shejkhul Albani në "Sahihu Ibn Maxheh" (2/364), si dhe ka thënë Shejkhul Islam Ibn Tejmijjeh: "Hadithi është i saktë, i njohur, si dhe është transmetuar në librat e Suneneve dhe Musnedeve." (Mexhmu'ul fetaua, 3/345).

78. Cili është argumenti prej Kur'anit fisnik për pohimin e Cilësisë së qëndrimit të Allahut mbi krijesat e Tij?

Përgjigje: Argumenti për pohimin e kësaj Cilësie është Fjala e Allahut të Lartësuar:

{أَأَمِنتُم مَّن فِي السَّمَاءِ أَن يَخْسِفَ بِكُمُ الْأَرْضَ فَإِذَا هِيَ تَمُورُ}

"A mos vallë u garantuat prej Atij që është lart mbi qiell, se nuk do t'ju fundosë në tokë, e ajo papritur të fillojë të dridhet?!" [El-Mulk, 16]

Dhe Fjala e Allahut të Lartësuar:

{سَبِّحِ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى}

"Lavdëro Emrin e Zotit tënd, më të Lartit." [El-Ea'la, 1]

Si dhe shumë ajete të tjera që e vërtetojnë këtë.

79. Cili është argumenti prej sunetit për pohimin e Cilësisë së qëndrimit të Allahut mbi krijesat e Tij?

Përgjigje: Argumenti për pohimin e kësaj Cilësie është hadithi i robëreshës, e cila, kur e pyeti Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*: "Ku është Allahu?"

Ajo tha: "Lart, mbi qiell."

Më pas i tha: "Kush jam unë?"

Ajo tha: "Ti je i Dërguari i Allahut."

Më pas i tha pronarit të saj: "Liroje, sepse ajo është muslimane." [Transmeton Muslim, 537]

80. Cili është argumenti për pohimin e Cilësisë së Lartësimit të Allahut mbi Arsh?

Përgjigje: Argumenti për pohimin e Cilësisë së istiuasë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

الرَّحْمَٰنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَىٰ

"I Gjithëmëshirshmi u lartësua mbi Arsh." [TaHa, 5]

Gjithashtu ka ardhur në gjashtë vende në Kur'an ku Allahu i Lartësuar thotë:

ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ

"(Allahu) u lartësua mbi Arsh"; në suren [el-E'araf, 54], në suren [Junus, 3], në suren [Err-Rra'd, 2], në suren [el-Furkan, 59], në suren [es-Sexhdeh, 4], në suren [el-Hadid, 4]

81. Çfarë do të thotë *el-istiua*?

Përgjigje: El-istiua do të thotë lartësim dhe qëndrim mbi diçka, domethënë Allahu u lartësua dhe qëndroi mbi Arsh.

Pra, domethënia e istiuasë është e njohur në gjuhën arabe, ndërsa mënyra se si është ajo, mbetet e panjohur. Siç ka thënë Imam Maliku, Allahu e mëshiroftë: "Istiuaja është e njohur, mënyra se si, është e panjohur. Besimi në të është obligim, ndërsa pyetja rreth saj është bidat (risi)." Pra, pyetja për mënyrën se si është ajo, është bidat. Ky parim përfshin të gjitha Cilësitë e Allahut, sepse ato janë të njohura për nga kuptimi, por të panjohura për nga mënyra se si janë.

82. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me Kur'anin fisnik?

Përgjigje: Besimi i pasuesve të Sunetit dhe Xhematit në lidhje me Kur'anin është se ai është Fjala e Allahut të Lartësuar. Shkronjat dhe kuptimet e tij janë të shpallura. Ai është shpallje, nuk është i krijuar. Ai ka dalë prej Allahut dhe tek Ai do të kthehet. Allahu ia ka folur atë realisht Xhibrilit, i cili e zbriti në zemrën e Profetit tonë Muhamedit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

83. Cili është argumenti se Kur'ani fisnik është Fjalë e Allahut të Lartësuar?

Përgjigje: Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَإِنْ أَحَدٌ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ اسْتَجَارَكَ فَأَجِرْهُ حَتَّىٰ يَسْمَعَ كَلَامَ اللَّهِ

"E nëse ndonjë prej idhujtarëve kërkon strehim te ti, atëherë strehoje, që të dëgjojë Fjalën e Allahut." [Et-Teube, 6]

Me "Fjalën e Allahut", të përmendur në këtë ajet, është për qëllim Kur'ani.

84. Cili është argumenti se Kur'ani fisnik është i shpallur, i zbritur dhe nuk është i krijuar?

Përgjigje: Argumenti se Kur'ani është i shpallur është Fjala e të Lartësuarit:

تَبَارَكَ الَّذِى نَزَّلَ الْفُرْقَانَ عَلَىٰ عَبْدِهِ لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا

"I Madhëruar është Ai që ia zbriti Furkanin (Kur'anin) robit të Tij, që të jetë paralajmërues për të gjithë botët." [El-Furkan, 1]

Ndërsa argumenti se Kur'ani nuk është i krijuar, është Fjala e Allahut:

أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ

"Pa dyshim se vetëm Atij i takon krijimi dhe Urdhërimi." [El-Ea'raf, 54]

Pra, Allahu e ndau Urdhërimin prej krijimit. Ndërsa Kur'ani është prej Urdhërimit, si argument për këtë është Fjala e Allahut:

وَكَذَٰلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ رُوحًا مِّنْ أَمْرِنَا ۚ

"Po ashtu Ne ta shpallëm ty Kur'anin prej Urdhrit Tonë." [Esh-Shuura, 52]

Gjithashtu, Fjala e Allahut është Cilësi prej Cilësive të Tij, ndërsa Cilësitë e Allahut të Lartësuar nuk janë të krijuara.

85. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me shikimin e Allahut të Lartësuar?

Përgjigje: Besimi i Pasuesve të Sunetit dhe Xhematit në lidhje me shikimin e Allahut të Lartësuar është se besimtarët do ta shohin Zotin e tyre drejtpërdrejt, me sytë e tyre, në Ditën e Gjykimit dhe në Xhennet.

86. Cili është argumenti se besimtarët do ta shohin Zotin e tyre në Botën tjetër?

Përgjigje: Argumenti se besimtarët do ta shohin Zotin e tyre në Botën tjetër është Fjala e të Lartësuarit:

وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاضِرَةٌ. إِلَىٰ رَبِّهَا نَاظِرَةٌ

"Atë ditë disa fytyra do të shkëlqejnë. Se Zotin e tyre do të shohin." [El-Kijameh, 22-23]

Gjithashtu, fjala e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

إِنَّكُمْ سَتَرَوْنَ رَبَّكُمْ كَمَا تَرَوْنَ الْقَمَرَ۞ لَا تُضَامُّونَ فِي رُؤْيَتِهِ

"Vërtet, ju do ta shihni Zotin tuaj ashtu siç e shihni hënën e plotë. Nuk do të keni asnjë vështirësi dhe nuk do të shtyheni me njëri tjetrin për ta parë Atë." [Transmeton el-Bukharij (7434), Muslim (633)]

87. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me imanin?

Përgjigje: Pasuesit e sunetit dhe xhematit besojnë se imani përbëhet nga:

1. Besimi i zemrës,
2. Pohimi me gjuhë,
3. Veprimi me gjymtyrë,
4. Ai shtohet me bindje ndaj Allahut,
5. Pakësohet me mëkate.

(Përkufizimi i imanit: Besim me zemër, pohim me gjuhë dhe veprim me gjymtyrë; ai shtohet me bindje ndaj Allahut dhe pakësohet me mëkate.)

88. Cili është argumenti se fjala dhe vepra janë prej imanit?

Përgjigje: Argumenti se fjala dhe vepra janë prej imanit është fjala e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

الْإِيمَانُ بِضْعٌ وَسَبْعُونَ شُعْبَةً۞ فَأَفْضَلُهَا قَوْلُ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ۞ وَأَدْنَاهَا إِمَاطَةُ الْأَذَى عَنِ الطَّرِيقِ۞ وَالْحَيَاءُ شُعْبَةٌ مِنَ الْإِيمَانِ

"Imani ka mbi shtatëdhjetë degë. Më e larta prej tyre është fjala: 'La ilahe il-lAllah', ndërsa më e ulëta është largimi i një pengese nga rruga. Edhe turpi është një degë e imanit." [Transmeton el-Bukharij (9), Muslim (35)]

Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, e bëri fjalën dhe veprën prej imanit.

89. Cili është argumenti se imani shtohet dhe pakësohet?

Përgjigje: Argumenti se imani shtohet është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَيَزْدَادَ الَّذِينَ آمَنُوا إِيمَانًا

"Ndërsa atyre që besuan t'u shtohet imani." [El-Muddeththir, 31]

Ndërsa argumenti se imani mund të pakësohet apo të dobësohet është fjala e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

مَنْ رَأَى مِنْكُمْ مُنْكَرًا فَلْيُغَيِّرْهُ بِيَدِهِ۞ فَإِنْ لَمْ يَسْتَطِعْ فَبِلِسَانِهِ۞ فَإِنْ لَمْ يَسْتَطِعْ فَبِقَلْبِهِ۞ وَذَلِكَ أَضْعَفُ الْإِيمَانِ

"Kush prej jush sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij. Nëse nuk ka mundësi, atëherë me gjuhën e tij. E nëse nuk ka mundësi as për këtë, atëherë me zemrën e tij. Kjo është shkalla më e dobët e imanit." [Transmeton Muslim, 49]

90. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me atë që bën mëkate të mëdha? Shoqëroje përgjigjen me argumentin përkatës.

Përgjigje: Gjykimi i pasuesve të Sunetit dhe Xhematit për vepruesin e mëkateve të mëdha është se ai nuk bën kufër (nuk del nga feja) për shkak të mëkatit të tij dhe nuk do të qëndrojë përgjithmonë në Zjarr. Çështja e tij është në vullnetin e Allahut: nëse Ai dëshiron, e dënon sipas asaj që meriton; e nëse dëshiron, e fal.

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَٰلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ

"Vërtet, Allahu nuk fal që t'i shoqërohet Atij dikush në adhurim, ndërsa çdo mëkat tjetër përveç kësaj ia fal kujt të dojë." [En-Nisa: 48]

91. Çfarë gjykimi ka shpallja kafir (mosbesimtar) e një besimtari? Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Shpallja kafir e një besimtari është haram (e ndaluar), dhe është prej mëkateve të mëdha.

Argumenti për këtë është fjala e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

مَنْ رَمَى مُؤْمِنًا بِكُفْرٍ۞ فَهُوَ كَقَتْلِهِ

"Kush e akuzon një besimtar për kufër (mosbesim), është sikur ta ketë vrarë." [Transmeton el-Bukharij, 6105]

92. Cili është qëndrimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me sprovën e varrit, shpërblimin në të dhe dënimin në të? Cili është argumenti për këtë?

Përgjigje: Pasuesit e sunetit dhe xhematit e besojnë sprovën e varrit, e cila është pyetja që i bëhet të vdekurit për Zotin e tij, fenë e tij dhe Profetin e tij.

Ata gjithashtu e besojnë shpërblimin në varr dhe ndëshkimin në të.

Argumenti për këtë është Fjala e të Lartësuarit:

النَّارُ يُعْرَضُونَ عَلَيْهَا غُدُوًّا وَعَشِيًّا ۖ وَيَوْمَ تَقُومُ السَّاعَةُ أَدْخِلُوا آلَ فِرْعَوْنَ أَشَدَّ الْعَذَابِ

"Ata i ekspozohen Zjarrit në mëngjes dhe në mbrëmje. E kur të vijë Ora (e Kiametit, do të thuhet): Futeni familjen e Faraonit në dënimin më të rëndë." [Gafir, 46]

Gjithashtu, është vërtetuar se Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, i kërkonte mbrojtje Allahut nga dënimi i varrit. [Transmeton el-Bukharij (798), Muslim (589)]

93. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me domosdoshmërinë e qëndrimit me xhematin? Përmendni edhe argumentin.

Përgjigje: Pasuesit e Sunetit dhe Xhematit besojnë se është obligim të kapesh fort pas xhematit të muslimanëve dhe prijësit të tyre, si dhe të mos ndahesh e të mos përçahesh prej tyre.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَاعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا

"Kapuni që të gjithë fort pas litarit të Allahut dhe mos u përçani." [Al 'Imran: 103]

94. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me bindjen ndaj prijësit? Përmendni edhe argumentin.

Përgjigje: Pasuesit e sunetit dhe xhematit besojnë se është obligim ta dëgjosh dhe t'i bindesh prijësit të muslimanëve në çdo gjë të mirë.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

ۖ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنكُمْ

"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe prijësve tuaj." [En-Nisa: 59]

Gjithashtu, Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, ka thënë:

عَلَى الْمَرْءِ الْمُسْلِمِ السَّمْعُ وَالطَّاعَةُ فِيمَا أَحَبَّ وَكَرِهَ۝ إِلَّا أَنْ يُؤْمَرَ بِمَعْصِيَةٍ۝ فَإِنْ أُمِرَ بِمَعْصِيَةٍ فَلَا سَمْعَ۝ وَلَا طَاعَةَ

"Muslimani e ka për detyrë ta dëgjojë dhe t'i bindet prijësit, si në atë që e pëlqen, ashtu edhe në atë që e urren, përveçse kur urdhërohet për mëkat. Nëse urdhërohet për mëkat, atëherë nuk ka dëgjim e as bindje." [Transmeton el-Bukharij (7144), Muslim (1839)]

95. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me sahabët (shokët e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*)?

Përgjigje: Besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me sahabët është që zemrat e tyre të jenë të pastra nga urrejtja, mëria dhe mllefi ndaj tyre, ndërsa gjuhët e tyre të jenë të ruajtura nga shpifja, mallkimi dhe fyerja e shokëve të të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

Përkundrazi, duhet t'i duan ata, ta njohin pozitën e tyre, t'i luten Allahut që të jetë i kënaqur me ta, si dhe t'i pasojnë ata me përpikëri. Ashtu siç i ka përshkruar Allahu të këtillët në Fjalën e Tij:

وَالَّذِينَ جَاءُوا مِن بَعْدِهِمْ يَقُولُونَ رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِّلَّذِينَ آمَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ

"Ata që erdhën pas tyre thonë: 'Zoti ynë! Na fal neve dhe vëllezërit tanë që na paraprinë në besim, dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë urrejtje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë! Vërtet, Ti je i Buti dhe Mëshiruesi." [El-Hashr: 10]

96. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me familjen (Ehli Bejtin) e të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*?

Përgjigje: Besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me familjen e të Dërguarit të Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, është se ata i duan Ehli Bejtin për dy arsye:

1. Për shkak se janë besimtarë,
2. Për shkak të afërsisë së tyre me të Dërguarin e Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.

Megjithatë, ata nuk e teprojnë në dashurinë ndaj tyre, e t'i adhurojnë ata krahas Allahut, apo të besojnë se janë të pagabueshëm.

97. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me dashurinë (el-uelaa) dhe urrejtjen (el-beraa)?

Përgjigje: Besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me dashurinë dhe urrejtjen është se këto janë prej domosdoshmërive të imanit dhe prej kërkesave të fjalës "La ilahe il-lAllah" (nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut).

El-uelaa (dashuria): Është dashuria për Allahun e Lartësuar, për të Dërguarin e Tij, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe për besimtarët.

El-beraa (urrejtja): Është urrejtja ndaj kufrit (mosbesimit) dhe mosbesimtarëve, mosmiqësimi me ta dhe shmangia e përngjasimit me ta në ato gjëra që janë veçori të tyre.

Megjithatë, kjo urrejtje nuk do të thotë t'u bësh padrejtësi atyre, t'u cenosh të drejtat e tyre, apo të shkëpusësh marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me ta. Përkundrazi, Islami e ka bërë të ligjshme sjelljen me mirësi dhe bamirësi ndaj atyre prej tyre që jetojnë në paqe me muslimanët.

98. Cili është besimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me Isain (Jezusin), *alejhis-selam*.

Përgjigje: Besimi i pasuesve të Sunetit dhe Xhematit në lidhje me Isain (Jezusin), alejhis-selam, është se ai është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij. Ai është rob, prandaj nuk lejohet të adhurohet; është i Dërguar, prandaj nuk lejohet të

përgënjeshtrohet. Ai është njeri prej bijve të Ademit, i krijuar nga Allahu prej një nëne, pa pasur baba.

99. Cili është qëndrimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me fetë e tjera, si Hebraizmi dhe Krishterimi?

Përgjigje: Pasuesit e Sunetit dhe Xhematit besojnë se feja Islame i ka shfuqizuar të gjitha fetë e mëparshme dhe se Allahu i Lartësuar nuk pranon asnjë fe tjetër pas dërgimit të Profetit Muhammed, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, përveç fesë Islame.

100. Cili është argumenti nga Kur'ani fisnik se feja Islame është feja e vërtetë, ndërsa çdo fe tjetër përveç saj është e kotë?

Përgjigje: Argumenti nga Kur'ani fisnik që dëshmon se Islami është feja e vërtetë dhe se çdo fe tjetër përveç tij është e kotë, është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَمَن يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَن يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ

"E kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, nuk do t'i pranohet kurrë, dhe ai në botën tjetër do të jetë prej të humburve." [Al 'Imran: 85]

101. Cili është argumenti nga Suneti që tregon obligueshmërinë e besimit te Profeti Muhammed, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe në atë me të cilën është dërguar?

Përgjigje: Argumenti nga Suneti që tregon obligueshmërinë e besimit te Profeti Muhammed, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe në Islamin me të cilin erdhi është fjala e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

وَالَّذِى نَفْسُ مُحَمَّدٍ بِيَدِهِ۞ لَا يَسْمَعُ بِى أَحَدٌ مِنْ هَذِهِ الْأُمَّةِ يَهُودِىٌّ وَلَا نَصْرَانِىٌّ۞ ثُمَّ يَمُوتُ۞ وَلَمْ يُؤْمِنْ بِالَّذِى أُرْسِلْتُ بِهِ إِلَّا كَانَ مِنْ أَصْحَابِ النَّارِ

"Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhammedit! Nuk dëgjon për mua askush nga ky umet, qoftë hebre apo i krishterë, e pastaj vdes pa besuar në atë me të cilën jam dërguar, veçse do të jetë prej banorëve të Zjarrit." [Transmeton Muslim, 153]

102. Cili është qëndrimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me tekstet e Kur'anit dhe sunetit? Përmend argument për këtë.

Përgjigje: Qëndrimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit ndaj teksteve të Kur'anit dhe sunetit është t'u dorëzohen plotësisht teksteve të Kur'anit dhe Sunetit të saktë, t'u binden atyre dhe të mos i kundërshtojnë me mendim personal, me logjikë, me imitim të verbër (taklid) ose me pasim të epshit.

Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنفُسِهِمْ حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

"Jo, pasha Zotin tënd! Ata nuk do të besojnë derisa të të marrin ty për gjykatës në mosmarrëveshjet që lindin mes tyre, pastaj të mos ndiejnë në vetveten e tyre asnjë ngushtim për gjykimin që ke dhënë dhe t'i nënshtrohen atij me nënshtrim të plotë." [En-Nisa: 65]

103. Cili është qëndrimi i pasuesve të sunetit dhe xhematit në lidhje me xhihadin në rrugë të Allahut? Cili është synimi i tij dhe cilat janë kushtet më të rëndësishme të tij?

Përgjigje: Pasuesit e sunetit dhe xhematit besojnë se xhihadi është maja më e lartë e Islamit, dhe është ligjësuar për një synim madhështor: Që Fjala e Allahut të jetë më e larta.

Megjithatë, është e domosdoshme që të plotësohen kushtet e tij, ndër të cilat më të rëndësishmet janë: fuqia dhe mundësia, si dhe të jetë nën një flamur të organizuar nga prijësi i shtetit të muslimanëve. Argument për këtë është fjala e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

إِنَّمَا الْإِمَامُ جُنَّةٌ يُقَاتِلُ مِنْ وَرَائِهِ۞ وَيُتَّقَى بِهِ

"Me të vërtetë, udhëheqësi është mburojë; luftohet pas tij dhe mbrohesh përmes tij." [Transmeton el-Bukharij (2957), Muslim (1841)]

104. Cili është qëndrimi i pasuesve të Sunetit dhe Xhematit ndaj veprimeve të grupeve terroriste, të cilat ata i quajnë "xhihad"?

Përgjigje: Pasuesit e sunetit dhe xhematit distancohen prej veprimeve të terroristëve edhe nëse ata i quajnë "xhihad". Sepse ata ndjekin metodologjinë e khauarixhëve (ekstremistëve), të cilët e kundërshtojnë metodologjinë e Islamit të saktë. Veprimet e tyre janë vepra të urryera dhe të qortueshme, të cilat kanë pasoja të këqija në shtrembërimin e imazhit të Islamit dhe muslimanëve, në frikësimin e njerëzve të sigurt dhe në vrasjen e të pafajshmëve të mbrojtur.

11. Kapitulli i abdesit dhe i guslit

105. Çfarë do të thotë abdes?

Përgjigje: Abdesi është larja dhe fërkimi (me dorë të lagur) i disa gjymtyrëve të caktuara, në një mënyrë të caktuar.

106. Cili është argumenti se abdesi është obligim për të falur namazin?

Përgjigje: Argumenti për obligueshmërinë e tij për të falur namazin është fjala e Allahut të Lartësuar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ

"O ju që besuat! Kur doni të falni namaz, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla, fërkoni (me dorë të lagur) kokat tuaja dhe lani këmbët tuaja deri te nyjat e këmbëve." [El-Maide: 6]

Gjithashtu, është transmetuar në dy librat e sakta të haditheve nga Ebu Hurejrah se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, ka thënë:

لَا يَقْبَلُ اللَّهُ صَلَاةَ أَحَدِكُمْ إِذَا أَحْدَثَ حَتَّىٰ يَتَوَضَّأَ

"Allahu nuk e pranon namazin e ndonjërit prej jush, nëse ai e prish abdesin, derisa të marrë abdes." [Transmeton el-Bukharij (6954), Muslim (537)]

107. Cilat janë kushtet e abdesit?

Përgjigje: Kushtet e abdesit janë dhjetë:

1. Islami (abdesi i quhet vetëm muslimanit).
2. Logjika (të jetë i shëndoshë mendërisht).
3. Arritja e moshës së temjizit (dallimit mes të mirës dhe të keqes).
4. Nijeti (qëllimi).
5. Vazhdimësia e nijetit, duke mos pasur për qëllim ta ndërpresë atë derisa të përfundojë pastrimin e tij.
6. Ndërprerja e shkakut që e prish abdesin (siç është ndërprerja e daljes së urinës, jashtëqitjes).

7. Pastrimi i vendeve intime me ujë (istinxha) ose me gurë e të ngjashme (istixhmar), para abdesit, në rast të urinimit ose jashtëqitjes.
8. Uji të jetë i pastër dhe i lejuar për t'u përdorur.
9. Heqja e çdo gjëje që pengon ujin të arrijë në lëkurë.
10. Hyrja e kohës së namazit për atë që ka një papastërti të vazhdueshme (si rrjedhje e vazhdueshme e urinës ose çrregullim menstrual).

108. Cilat janë obligimet e abdesit?

Përgjigje: Obligimet e abdesit janë gjashtë:

1. Larja e fytyrës, ku përfshihen edhe shpëlarja e gojës (el-madmadah) dhe futja e ujit në hundë (el-istinshak).
2. Larja e duarve deri në bërryla, duke i përfshirë edhe bërrylat.
3. Fshirja e kokës, ku përfshihen edhe veshët.
4. Larja e këmbëve deri te nyjat e këmbëve (kyçet), duke i përfshirë edhe ato.
5. Renditja, që do të thotë: larja e gjymtyrëve të abdesit sipas rendit të caktuar; pra, së pari lahet fytyra, pastaj duart, më pas fërkohet koka me duar të lagura dhe në fund lahen këmbët, ashtu siç ka urdhëruar Allahu i Lartësuar në ajetin e abdesit në suren El-Maide.
6. Vazhdimësia, që do të thotë: larja e gjymtyrëve të abdesit të bëhet njëra pas tjetrës, pa ndërprerje, aq sa është e mundur.

109. Cila është mënyra e kryerjes së abdesit?

Përgjigje: Mënyra e kryerjes së abdesit, ashtu siç ka ardhur në Kur'an dhe Sunet, është si vijon:

Së pari: Ai që dëshiron të marrë abdes fillon me pastrimin me ujë të vendeve intime ose pastrimin e tyre me gurë, letër ose të ngjashme, nëse prej tij ka dalë urinë ose jashtëqitje.

Së dyti: Nëse është në gjendje papastërtie të vogël (ka humbur abdesin), por nuk i ka dalë urinë ose jashtëqitje, atëherë fillon menjëherë me abdesin.

Së treti: E bën nijetin në zemër për të larguar papastërtinë rituale (marrë abdes), pa e shqiptuar atë me gjuhë. Pastaj thotë: Bismil-Lah (filloj me Emrin e Allahut).

Së katërti: Është e pëlqyeshme që në fillim të abdesit t'i lajë shuplakat e duarve tri herë.

Së pesti: Shpëlan gojën dhe fut ujë në hundë tri herë, me tri grushte uji. Nga çdo grusht uji shpëlan gojën dhe fut ujë në hundë. Shpëlarja e gojës dhe futja e ujit në hundë bëhet me dorën e djathtë, ndërsa nxjerrja e ujit nga hunda bëhet me dorën e majtë.

Shpëlarja e gojës bëhet duke e lëvizur ujin në gojë, ndërsa istinshaku është futja e ujit në hundë dhe istinthari është nxjerrja e tij.

Së gjashti: E lan fytyrën tri herë. Kufijtë e fytyrës janë: nga njëri vesh te tjetri në gjerësi dhe nga vendi ku zakonisht mbijnë flokët e kokës deri poshtë mjekrës në gjatësi.

Së shtati: I lan duart nga majat e gishtave deri mbi bërryla tri herë. Fillon me dorën e djathtë, pastaj me të majtën. Edhe bërrylat përfshihen në larje.

Së teti: E fërkon kokën me duar të lagura një herë. I lag duart me ujë, pastaj fillon e fërkon nga pjesa e përparme e kokës, i kalon duart deri në pjesën e pasme, pastaj i kthen përsëri në vendin nga ku filloi.

Së nënti: I fshin veshët, duke futur gishtat tregues në pjesën e brendshme të veshëve dhe duke fshirë pjesën e jashtme të tyre me gishtat e mëdhenj.

Së dhjeti: I lan këmbët deri te kyçet tri herë. Fillon me këmbën e djathtë, pastaj me të majtën. Edhe kyçet përfshihen në larje.

Së njëmbëdhjeti: Pas përfundimit të abdesit është e pëlqyeshme të thotë:

Esh'hedu en la ilahe il-lAllah, ue esh'hedu enne Muhammeden 'abduhu ue Resuuluhu

"Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij."

Kush e thotë këtë pas abdesit, atij i hapen tetë dyert e Xhenetit dhe hyn nga cilado që dëshiron, siç është vërtetuar në hadithin e saktë.

Nëse ai që merr abdes mjaftohet me larjen e shuplakave, fytyrës, duarve dhe këmbëve nga një herë ose nga dy herë, nuk ka asnjë problem. Kjo sepse Profeti,

sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ka marrë abdes duke i larë gjymtyrët nga një herë, nga dy herë dhe nga tri herë.

Megjithatë, më e pëlqyeshmja është që gjymtyrët të lahen nga tri herë.

110. Cilat janë gjërat që ta prishin abdesin?

Përgjigje: Prishësit e abdesit janë katër:

1. Çdo gjë që del nga dy rrugët e daljes së nevojave fiziologjike (nga organi urinar ose ai i jashtëqitjes), pa marrë parasysh se çfarë del.
2. Humbja e vetëdijes, qoftë për shkak të çmendurisë, të fikëtit ose gjumit të thellë.
3. Ngrënia e mishit të devesë.
4. Prekja e organit gjenital (penisit, vaginës) me dorë, pa ndonjë pengesë (si p.sh. rrobë ose dorezë).

111. Çfarë do të thotë gusël?

Përgjigje: Gusli është hedhja e ujit mbi tërë trupin, sipas një mënyre të caktuar.

112. Cilat janë shkaqet që e bëjnë të detyrueshëm guslin?

Përgjigje: Shkaqet që e bëjnë të detyrueshëm guslin janë tre:

1. Dalja e spermës me vrull dhe me kënaqësi (epsh).
2. Marrdhënia intime, edhe nëse nuk ndodh derdhja e spermës.
3. Dalja e gjakut të menstruacioneve ose të lehonisë.

113. Cili është argumenti që tregon obligueshmërinë e guslit kur ndodh një prej shkaqeve që e bëjnë atë obligim?

Përgjigje: Argumenti për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا

"E nëse jeni në gjendje xhunubllëku, atëherë pastrohuni (duke marrë gusl)." [El-Maideh, 6]

114. Cila është mënyra e kryerjes së guslit?

Përgjigje: Gusli është dy llojesh: gusli i plotë dhe gusli i vlefshëm (i mjaftueshëm).

1. Mënyra e guslit të plotë është që njeriu të bëjë nijet në zemër për largimin e papastërtisë së madhe, pastaj të thotë: "Bismil-Lah", t'i lajë duart tri herë, pastaj të lajë organin gjenital dhe pjesët intime, më pas të marrë abdes të plotë, pastaj të hedhë tre grushte ujë mbi kokë duke i depërtuar uji deri në rrënjët e flokëve me gishta, e më pas ta lajë pjesën tjetër të trupit një herë.
2. Ndërsa mënyra e guslit të vlefshëm (të mjaftueshëm) është që njeriu të bëjë nijet në zemër për largimin e papastërtisë së madhe, pastaj të thotë: "Bismil-Lah", dhe ta përfshijë të gjithë trupin me ujë një herë, duke bërë edhe shpëlarjen e gojës dhe futjen e ujit në hundë e nxjerrjen e tij.

[Shënim i përkthyesit: Gusli i vlefshëm (i mjaftueshëm), lejohet të merret vetëm në rastet e marrëdhënieve intime, xhunublëkut, pas përfundimit të menstruacioneve, dhe pas përfundimit të lehonisë.]

115. Cilat janë dobitë e abdesit dhe të guslit?

Përgjigje: Dobitë dhe urtësitë e abdesit dhe të guslit janë të shumta, ndër më kryesoret janë:

1. Islami është një fe madhështore, e cila thërret në pastërtinë fizike dhe në pastërtinë kuptimore (shpirtërore).
2. Ato janë shkak për ngritjen e gradëve dhe shlyerjen e gabimeve e të mëkateve.
3. Përgatitje për t'iu drejtuar Allahut të Lartësuar në namaz, në gjendjen më të mirë.
4. Ruajtja e shëndetit, sigurisë dhe gjallërisë së trupit.

12. Kapitulli i namazit

116. Çfarë do të thotë namaz?

Përgjigje: Namazi është adhurimi ndaj Allahut të Lartësuar me fjalë dhe veprime të caktuara, që fillon me tekbirin (Allahu Ekber) dhe përfundon me selamin.

117. Cilat janë namazet e detyrueshme për çdo musliman dhe muslimane?

Përgjigje: Namazet e detyrueshme janë pesë namaze gjatë ditës dhe natës:

1. Namazi i sabahut - dy rekate.
2. Namazi i drekës - katër rekate.
3. Namazi i ikindisë - katër rekate.
4. Namazi i akshamit - tre rekate.
5. Namazi i jacisë - katër rekate.

118. Cili është argumenti për obligueshmërinë e namazit?

Përgjigje: Namazi është shtylla më e madhe e Islamit pas dy dëshmive (shehadetit). Argumenti për obligueshmërinë e tij gjendet në Kur'an, Sunet dhe Ixhma (konsensusin e dijetarëve).

1. Sa i përket Kuranit, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ﴾

"Faleni namazin." [El-Bekareh: 43]

2. Sa i përket Sunetit, transmetohet nga Abdullah Ibn Umeri, radijAllahu anhuma, se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, ka thënë:

بُنِيَ الْإِسْلَامُ عَلَى خَمْسٍ شَهَادَةِ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ۞ وَأَن مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ وَإِقَامِ الصَّلَاةِ۞ وَإِيتاءِ الزَّكَاةِ وَحَجِ الْبَيْتِ۞ وَصَوْمِ رَمَضَانَ

"Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhanmedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, haxhi në Shtëpinë e Shenjtë (Qabe) dhe agjërimi i Ramazanit." [Transmeton el-Bukharij (8), Muslim (21)]

3. Sa i përket Ixhmasë (konsensusit të dijetarëve), muslimanët janë pajtuar njëzëri për detyrueshmërinë e pesë namazeve dhe se ai që e mohon detyrueshmërinë e tyre është jobesimtar (kafir).

119. Cili është gjykimi për lënien (mosfaljen) e namazit dhe cili është argumenti?

Përgjigje: Lënia e namazit është kufër (mosbesim) që e nxjerr njeriun nga Islami, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve.

Argumenti është fjala e Profetit:

إِن بَيْنَ الرَّجُلِ وَبَيْنَ الشِّرْكِ وَالْكُفْرِ تَرْكَ الصَّلَاةِ

"Me të vërtetë, ndërmjet njeriut dhe shirkut (politeizmit) e kufrit (mosbesimit) është lënia e namazit." [Transmeton Muslim, 82]

[Shënim i përkthyesit: Ka mospajtime te dijetarët për atë njeri që nuk e fal namazin por e pohon obligueshmërinë e tij: Disa prej tyre e shpallin si mosbesimtar e disa e shpallin si mëkatar të madh.]

120. Cilat janë kushtet (shurutet) e namazit?

Përgjigje: Kushtet e namazit janë nëntë:

1. Islami (namazi i pranohet vetëm muslimanit).
2. Logjika (të jetë i shëndoshë mendërisht).
3. Arritja e moshës së dallimit (temjizi).
4. Nijeti.
5. Largimi i papastërtisë rituale (marrja e abdesit ose guslit kur kërkohet).
6. Heqja e papastërtive nga trupi, rrobat dhe vendi i faljes.
7. Mbulimi i auretit (pjesëve të caktuara të trupit).
8. Hyrja e kohës së namazit.
9. Drejtimi nga kibla.

121. Cilat janë shtyllat (arkanet) e namazit?

Përgjigje: Shtyllat e namazit janë katërmbëdhjetë:

1. Qëndrimi në këmbë për atë që ka mundësi.
2. Tekbiri fillestar.

3. Leximi i sures el-Fatihah.
4. Rukuja.
5. Drejtimi në këmbë pas rukusë.
6. Sexhdeja mbi shtatë gjymtyrët.
7. Ngritja nga sexhdeja.
8. Ulja ndërmjet dy sexhdeve.
9. Arritja e qetësisë në të gjitha shtyllat.
10. Ruajtja e rendit të shtyllave.
11. Teshehhudi i fundit.
12. Ulja në teshehhudin e fundit.
13. Salauati për Profetin, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.
14. Dy selamet (dhënia e selamit nga të dyja anët në fund të namazit).

122. Cila është rëndësia e sures el-Fatihah?

Përgjigje: Sureja el-Fatihah është sureja më madhështore në Kur'an. Mësimi i saj është detyrë, sepse namazi nuk është i vlefshëm pa të.

Sipas konsensusit (ixhmasë) të dijetarëve, ajo përbëhet nga shtatë ajete, ndërsa "Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahiim" , sipas mendimit më të saktë, nuk është pjesë e saj.

Ajo është fjala e Allahut të Lartësuar:

1.	El-hamdu lil-Lahi Rabbil-'aalemiin	Lavdia dhe falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të gjithësisë
2.	Er-Rahmanir-Rahiim	Të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit
3.	Maliki jeumid-diin	Sunduesit të Ditës së Gjykimit
4.	IjjaKe nea'budu ue ijjaKe neste'iin	Ne vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë
5.	Ih'dines-siratal-mustekiim	Na udhëzo në rrugën e drejtë
6.	Siratal-ledhiine en'amte 'alejhim	Në rrugën e atyre që i ke begatuar (Pejgamberëve, të sinqertëve, shehidëve, të devotshmëve)!
7.	Gajril-magduubi 'alejhim ue led-daaal-liin	Jo në rrugën e atyre me të cilët Ti je i Zemëruar (çifutët dhe ata që janë të ngjashëm me ta), dhe të atyre që kanë devijuar (të krishterët dhe ata që janë të ngjashëm me ta)! [El-Fatihah, 1-7]

123. Cilat janë obligimet (uaxhibatet) e namazit?

Përgjigje: Obligimet e namazit janë tetë:

1. Të gjitha tekbiret, përveç tekbirit fillestar (tekbiretul-ihram).
2. Thënia: "Subhane Rabbijel-'Adhiim" në ruku.
3. Thënia: "Semi'-Allahu limen hamideh" nga imami dhe ai që falet vetëm.
4. Thënia: "Rabbena ue lekel-hamd" nga të gjithë.
5. Thënia: "Subhane Rabbijel-Ea'la" në sexhdeh.
6. Thënia: "Rabbi-gfir li" ndërmjet dy sexhdeve.
7. Teshehhudi i parë.
8. Ulja në teshehhudin e parë.

124. Cili është teshehhudi i parë?

Përgjigje: Teshehhudi i parë është kur ai që fal namazin thotë:

Et-tehij-jaatu lil-Lahi ues-salauatu uet-taj-jibaat, Es-selamu alejke ejjuhen-Nebijju ue rahmetull-Llahi ue berekaatuHu, Es-selamu alejna ue alaa ibadil-Lahis-saalihiin, Esh'hedu en la ilahe il-lAllah, ue esh'hedu enne Muhammeden abduHu ue ResuuluHu

Të gjitha madhërimet, të gjitha lutjet dhe adhurimet, lavdet, falënderimet dhe çdo vepër e mirë i takon Allahut. Shpëtimi, Mëshira dhe Begatia e Allahut qoftë mbi Pejgamberin, mbi ne dhe mbi të gjithë njerëzit e devotshëm. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

125. Kur bëhet teshehhudi i parë?

Përgjigje: Teshehhudi i parë bëhet kur ai që falet ulet pasi ka bërë sexhden e dytë në rekatin e dytë të namazit të Drekës, Ikindisë, Akshamit ose Jacisë.

126. Cili është teshehhudi i fundit?

Përgjigje: Teshehhudi i fundit është kur ai që fal namazin thotë:

Et-tehij-jaatu lil-Lahi ues-salauatu uet-taj-jibaat, Es-selamu alejke ejjuhen-Nebijju ue rahmetull-Llahi ue berekaatuHu, Es-selamu alejna ue alaa ibadil-Lahis-

saalihiin, Esh'hedu en la ilahe il-lAllah, ue esh'hedu enne Muhammeden abduHu ue ResuuluHu

Allahumme sal-li alaa Muhammedin ue alaa ali Muhammed, kema sal-lejte alaa Ibrahime ue alaa ali Ibrahim, inneke Hamiidun Mexhiid. Allahumme baarik alaa Muhammedin ue alaa ali Muhammed, kema baarekte alaa Ibrahime ue alaa ali Ibrahim, inneke Hamiidun Mexhiid

Të gjitha madhërimet, të gjitha lutjet dhe adhurimet, lavdet, falënderimet dhe çdo vepër e mirë i takon Allahut. Shpëtimi, Mëshira dhe Begatia e Allahut qoftë mbi Pejgamberin, mbi ne dhe mbi të gjithë njerëzit e devotshëm. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

O Allah, shpëtoje dhe lavdëroje Muhammedin dhe pasuesit e tij, ashtu siç e shpëtove dhe lavdërove Ibrahimin dhe pasuesit e tij, me të vërtetë që Ti je i Lavdëruari, i Madhërishmi dhe i Plotfuqishmi. O Allah, bekoje dhe begatoje me mirësitë e Tua Muhammedin dhe pasuesit e tij, ashtu siç e bekove dhe e begatove Ibrahimin dhe pasuesit e tij, me të vërtetë që Ti je i Lavdëruari, i Madhërishmi dhe i Plotfuqishmi.

127. Kur bëhet teshehhudi i fundit?

Përgjigje: Teshehhudi i fundit bëhet kur ai që falet ulet pasi ka bërë sexhden e dytë në rekatin e fundit të namazit.

128. Cilat janë sunetet e namazit?

Përgjigje: Sunetet e namazit janë të shumta dhe ndahen në dy lloje:

Lloji i parë: Sunete që thuhen me fjalë. Prej tyre janë:

1. Duaja e hapjes së namazit (duaja pas tekbirit fillestar), thënia "E'uudhu bil-Lahi minesh-shejtanirr-rraxhiim", thënia "Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahiim" dhe thënia e "Amiin".
2. Të thuhet më shumë se një herë "Subhane Rabbijel-'Adhiim" në ruku dhe, "Subhane Rabbijel-Ea'la" në sexhdeh.

3. Të thuhet më shumë se një herë "Rabbi-gfir lii" në qëndrimin ndërmjet dy sexhdeve.
4. Lutja në fund të teshehhudit të fundit.
5. Leximi me zë në namazin e sabahut, në dy rekatet e para të akshamit dhe jacisë, si dhe në namazin e xhumasë, të dy Bajrameve, në namazin e kërkimit të shiut dhe namazit të eklipsit.
6. Leximi pa zë në namazin e drekës dhe ikindisë, në rekatin e tretë të akshamit dhe në dy rekatet e fundit të jacisë.
7. Leximi i një sureje ose disa ajeteve nga Kurani pas sures El-Fatihah.

Lloji i dytë: Sunete vepruese. Prej tyre janë:

1. Vendosja e dorës së djathtë mbi të majtën gjatë qëndrimit në këmbë.
2. Ngritja e të dy duarve deri në lartësinë e shpatullave ose të veshëve në katër vende:

- gjatë tekbirit fillestar;
- para se të shkohet në ruku;
- kur ngrihet nga rukuja;
- kur ngrihet për rekatin e tretë pas teshehhudit të parë.

3. Mbajtja e kokës në një vijë me shpinën gjatë rukusë.
4. Largimi i krahëve nga anët e trupit dhe i barkut nga kofshët gjatë sexhdes.
5. Mbajtja e parakrahëve të ngritur nga toka gjatë sexhdes.
6. Iftirashi: ulja mbi këmbën e majtë, ndërsa këmba e djathtë mbahet e ngritur anash me gishtin tregues të saj drejtuar nga Kibla, në teshehhudin e parë, ndërmjet dy sexhdeve dhe në teshehhudin e fundit të namazit dy-rekatësh.
7. Teuerr-rruku: ulja në teshehhudin e fundit të namazit tre ose katër-rekatësh, duke u ulur mbi vithet (në tokë), me këmbën e majtë të nxjerrë poshtë këmbës së djathtë (e vendos mes gjurit dhe këmbës së djathtë), ndërsa këmba e djathtë mbahet e ngritur me gishtin tregues të saj nga Kibla.

129. Cili është dallimi ndërmjet shtyllave, obligimeve dhe suneteve të namazit?

Përgjigje:

- Shtylla: Nëse lihet, namazi prishet, qoftë me qëllim apo nga harresa.

- Obligimi: Nëse lihet me qëllim, namazi prishet. Ndërsa nëse lihet nga harresa, ai plotësohet me dy sexhdet e harresës (sehui sexhdeh).
- Suneti: Kryerja e tij është e pëlqyeshme dhe shpërblehet, por namazi nuk prishet nëse lihet, as me qëllim e as nga harresa.

130. Cila është forma e namazit?

Përgjigje: Forma e namazit, siç është transmetuar nga Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, është si vijon:

1. Muslimani drejtohet nga kibla, duke e bërë nijetin në zemër për namazin që dëshiron të falë, pa e shqiptuar atë me gjuhë. Pastaj, duke qëndruar në këmbë, thotë tekbirin fillestar: "Allahu Ekber" (Allahu është më i Madhi), ndërsa shikon në vendin e sexhdes.
2. Ngre duart, ku majat e gishtave janë deri në lartësinë e shpatullave ose të veshëve gjatë tekbirit fillestar. Më pas vendos dorën e djathtë mbi të majtën. Dijetarët kanë mendime të ndryshme për vendin e vendosjes së tyre: mbi kraharor, nën kërthizë, mbi kërthizë, ose aty ku dëshiron ai që falet.
3. Është e pëlqyeshme ta fillojë namazin me ndonjërën prej duave të hapjes që janë transmetuar nga Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*. Prej tyre është:

Subhaneke Allahumme ue bi hamdike, ue tebarake-smuke, ue te'alaa xhedduke, ue la ilahe gajruke."

I Pastër prej të metave e i Lartësuar je, o Allah, dhe Ty të takon falënderimi. I lavdëruar është Emri Yt, e lartësuar është Madhështia Jote dhe nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje.

Shumica e selefëve (dijetarëve të parë të Islamit) e fillonin namazin me këtë lutje, madje Umer ibnul Khattab, radijAllahu anhu, e ngrinte zërin kur thoshte këtë lutje në mënyrë që ta mësonin njerëzit.

4. Pas duasë së hapjes thotë: E'uudhu bil-Lahi minesh-shejtanirr-rraxhiim, Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahiim

(Kërkoj Mbrojtjen e Allahut prej shejtanit të mallkuar.

Me Emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit)

Pastaj lexon Suren El-Fatihah, e më pas lexon aq sa dëshiron nga Kur'ani.

5. Pastaj niset për në ruku, thotë "Allahu Ekber" duke ngritur duart deri në lartësinë e shpatullave ose të veshëve. Pasi qëndron në ruku, e mban kokën në një vijë me shpinën, pa e ulur e pa e ngritur. Vendos duart mbi gjunjë, me gishtat e hapur, qetësohet në ruku dhe thotë:

"Subhane Rabbijel-'Adhiim"

I Pastër prej të metave je, o Zoti im Madhështor

Është e pëlqyeshme që ta përsërisë tri herë këtë lutje.

6. E ngre kokën nga rukuja duke u drejtuar plotësisht në këmbë dhe i ngre duart deri në lartësinë e shpatullave ose të veshëve. Nëse është imam ose falet vetëm, thotë:

"Semiall-Llahu limen hamideH"

Allahu i përgjigjet lutjes së atij që e lavdëron dhe e falënderon Atë.

Pastaj, pasi të drejtohet plotësisht, thotë: "Rabbena ue lekel-hamd"

(Zoti ynë, Ty të takon lavdia dhe falënderimi).

Nëse dëshiron, shton: "Mil'es-semauati ue mil'el-erdi, ue mil'e ma shi'te min shej'in bad"

(Lavde e falënderime të cilat mbushin të gjithë qiejt dhe tokën, dhe aq sa dëshiron Ti përtej ekzistencës së qiejve dhe të tokës).

Kjo vlen për imamin, atë që falet vetëm dhe atë që është xhemat pas imamit. Pastaj qetësohet në këtë qëndrim. Është sunet t'i vendosë duart si në qëndrimin e parë (dorën e djathtë mbi të majtën), por nëse i lë të lira, nuk ka problem.

7. Pastaj bie në sexhde duke thënë "Allahu Ekber". Vendos gjunjët para duarve; nëse i vendos duart para gjunjëve, nuk ka problem. Gishtat e duarve dhe të këmbëve i drejton nga kibla, i mban gishtat e duarve të bashkuar dhe bën sexhde mbi shtatë gjymtyrë: ballin bashkë me hundën, dy duart, dy gjunjët, majat e gishtave të të dy këmbëve.

Në sexhde qetësohet dhe thotë:

"Subhane Rabbijel-ealaa"

I pastër nga të metat je, o Zoti im i Lartësuar

Është më e pëlqyeshme ta përsërisë tri herë.

Gjatë sexhdes i largon krahët nga anët e trupit, barkun nga kofshët, kofshët nga këmbët dhe nuk i mbështet parakrahët në tokë.

Gjithashtu, është e pëlqyeshme të bëjë sa më shumë dua në sexhde, sepse ajo është një vend ku lutja ka më shumë gjasa të pranohet.

8. E ngre kokën nga sexhdeja duke thënë "Allahu Ekber", ulet me qetësi në uljen mes dy sexhdeve: ulet mbi këmbën e majtë, ndërsa këmbën e djathtë e mban të ngritur me gishtat e saj drejtuar nga Kibla. Duart i vendos mbi kofshë dhe gjunjë dhe thotë:

"Rabbi-gfir lii"

O Zoti im, më fal

Është më e pëlqyeshme ta përsërisë tri herë. Gjithashtu, është e pëlqyeshme të thotë:

Allahumme-gfir lii, uerr-hamnii, uexh-burnii, ue aafinii, ueh-dinii, uerr-zuknii

O Allah! Më fal mua, më mëshiro, m'i zgjidh nevojat e mia, më jep mirëqenie dhe më shpëto prej fitneve në dunja dhe në Fe, më udhëzo në vepra të mira dhe më furnizo prej mirësive të Tua

9. Bën sexhden e dytë duke thënë "Allahu Ekber" dhe vepron në të njëjtën mënyrë si në sexhden e parë.
10. E ngre kokën nga sexhdeja duke thënë "Allahu Ekber" dhe ngrihet në këmbë, duke u mbështetur mbi majat (shputat e përparme) të këmbëve dhe mbi gjunjët e tij, për të vazhduar në rekatin tjetër.[4]

[4] Nëse nuk i është lehtësuar mbështetja në gjunj, atëherë mbështetet në tokë me duar kur ngrihet. Disa dijetarë e kanë konsideruar të pëlqyeshme që njeriu të ulet për një çast para se të ngrihet për në rekatin e dytë dhe para se të ngrihet për në rekatin e katërt. Kjo ulje quhet "xhelsetu'l-istirahah", domethënë ulje e shkurtër e pushimit.

Pastaj lexon Suren El-Fatihah dhe më pas aq sa dëshiron nga Kur'ani. Rekatin e dytë e fal njësoj si të parin.

11. Nëse namazi është dy-rekatësh, si namazi i sabahut ose i xhumasë, pasi ngrihet nga sexhdeja e dytë e rekatit të dytë, ulet për teshehhud. E mban këmbën e djathtë të ngritur dhe ulet mbi këmbën e majtë. Dorën e djathtë e vendos mbi kofshën e djathtë, i mbledh gishtat grusht, përveç gishtit tregues, të cilin e mban të drejtuar nga Kibla.[5] Dorën e majtë e vendos mbi kofshën dhe gjurin e majtë.
12. Në këtë ulje lexon teshehhudin dhe dërgon salauatet për Profetin, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*:

Et-tehij-jaatu lil-Lahi ues-salauatu uet-taj-jibaat, Es-selamu alejke ejjuhen-Nebijju ue rahmetull-Llahi ue berekaatuHu, Es-selamu alejna ue alaa ibadil-Lahis-saalihiin, Esh'hedu en la ilahe il-lAllah, ue esh'hedu enne Muhammeden abduHu ue ResuuluHu

Allahumme sal-li alaa Muhammedin ue alaa ali Muhammed, kema sal-lejte alaa Ibrahime ue alaa ali Ibrahim, inneke Hamiidun Mexhiid. Allahumme baarik alaa Muhammedin ue alaa ali Muhammed, kema baarekte alaa Ibrahime ue alaa ali Ibrahim, inneke Hamiidun Mexhiid

Të gjitha madhërimet, të gjitha Namazet dhe adhurimet, lavdet, falënderimet dhe çdo vepër e mirë i takon Allahut. Shpëtimi, Mëshira dhe Begatia e Allahut qoftë mbi Pejgamberin, mbi ne dhe mbi të gjithë njerëzit e devotshëm. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

O Allah, shpëtoje dhe lavdëroje Muhammedin dhe pasuesit e tij, ashtu siç e shpëtove dhe lavdërove Ibrahimin dhe pasuesit e tij, me të vërtetë që Ti je i Lavdëruari, i Madhërishmi dhe i Plotfuqishmi. O Allah, bekoje dhe begatoje me mirësitë e Tua Muhammedin dhe pasuesit e tij, ashtu siç e bekove dhe e begatove Ibrahimin dhe pasuesit e tij, me të vërtetë që Ti je i Lavdëruari, i Madhërishmi dhe i Plotfuqishmi.

[5] Ekziston edhe një mënyrë tjetër e vendosjes së gishtërinjve të dorës së djathtë, e cila është transmetuar nga Profeti, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: të përkulë gishtin e vogël dhe gishtin e unazës në formë grushti, pastaj të formojë një rreth duke bashkuar gishtin e madh me gishtin e mesëm, dhe të bëjë shenjë me gishtin tregues.

- Pastaj kërkon mbrojtje tek Allahu nga katër gjëra, duke thënë:

Allahumme inii euudhu biKe min adhabi Xhehennem, ue min adhabil-kabr, ue min fitnetil-mahja uel-memat, ue min sherr-rri fitnetil-mesiihid-dexh-xhal

O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde prej dënimit të Xhehennemit, prej dënimit në varr, prej sprovave të jetës dhe sprovave gjatë vdekjes, dhe prej së keqes së sprovave të Dexhallit.

Më pas lutet me çfarë të dëshirojë për të mirat e kësaj bote dhe të Botës tjetër.

13. Pastaj jep selam nga ana e djathtë, duke mos e zgjatur selamin, e thotë:

"Es-selamu alejkum ue rahmetull-Llah"

Më pas jep selam edhe nga ana e majtë me të njëjtat fjalë:

"Es-selamu alejkum ue rahmetull-Llah"

14. Nëse namazi është tre ose katër-rekatësh, si akshami, dreka, ikindia ose jacia, atëherë pas rekatit të dytë lexon vetëm ettehijjatun, pa shtuar salauatet. Pastaj ngrihet në këmbë duke u mbështetur mbi shputat e para të këmbëve dhe mbi gjunjë, i ngre duart deri në lartësinë e shpatullave ose të veshëve dhe thotë "Allahu Ekber".

Më pas në rekatin e tretë lexon vetëm Suren El-Fatihah dhe vazhdon pjesën e mbetur të rekatit.

Pas rekatit të tretë në namazin e akshamit ose pas rekatit të katërt në namazin e drekës, ikindisë dhe jacisë, ulet për teshehhudin e fundit, lexon ettehijjatin, dërgon salauatet për Profetin, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe bën duatë e transmetuara.

Në fund jep dy selamet, një në të djathtë dhe një në të majtë, ashtu si në namazin dyrekatësh.

Me këtë përfundon përshkrimi i formës së namazit.

- Pas përfundimit të namazit, është e pëlqyeshme që falësi t'i thotë dhikret dhe lutjet e transmetuara nga Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.
- Menjëherë pas selamit thotë:

Estagfirull-Llah, Estagfirull-Llah, Estagfirull-Llah. Allahumme Entes-Selaamu ue minKes-selaam, tebaarekte ja dhel-Xhelaali uel-Ikraam

Kërkoj faljen e Allahut! (3 herë). O Allah, Ti je Es-selam (i Pastër nga çdo mangësi, i Përsosuri), prej Teje vjen shpëtimi, i Lartësuar dhe i Madhëruar je Ti që e meriton Madhërimin dhe Lavdërimin.]

- Më pas thotë:

La ilahe il-lAllahu uah'deHu la sheriike leH, leHul-Mulku ue leHul-Hamdu ue Hue alaa kul-li shej'in Kadiir. Allahumme laa maania limaa eatajte ue laa mutije limaa menate ue la jenfau dhel-xheddi minKel-xhedd.

La ilahe il-lAllahu uah'deHu la sheriike leH, leHul-Mulku ue leHul-Hamdu ue Hue alaa kul-li shej'in Kadiir. La haule ue la ku-uete il-la bil-Lah. La ilahe il-lAllahu ue la nabudu il-la ijjaH, leHun-n`imetu ue leHul-fadlu ue leHuth-thenaaul-hasen. La ilahe il-lAllahu mukhlisiine leHud-diine ue leu kerihel-kaafiruun.

Nuk ka të adhuruar tjetër me të Drejtë përveç Allahut, të Vetëm e të Pashok. Atij i takon Sundimi dhe Lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. O Allah, askush nuk ka mundësi ta ndalojë atë që Ti ia jep dikujt, dhe askush nuk ka mundësi t'ia japë atë që Ti ia ke ndaluar dikujt. Dhe askujt nuk i bën dobi pasuria që ka, pasi prej Teje është gjithçka.

Nuk ka të adhuruar tjetër me të Drejtë përveç Allahut, të Vetëm e të Pashok. Atij i takon Sundimi dhe Lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Nuk ka lëvizje për njeriun nga një gjendje në një gjendje tjetër, dhe as forcë për të, vetëm se me Lejen e Allahut. Nuk ka të adhuruar tjetër me të Drejtë përveç Allahut, dhe ne nuk adhurojmë asgjë tjetër përveç Tij. Atij i përket çdo begati dhe mirësi, dhe Atij i takojnë lavdet më të mira. Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut. Atë e adhurojmë me sinqeritet dhe Teuhid, edhe nëse këtë gjë e urrejnë kafirat.

- Më pas thotë:

"SubhanAllah" (33 herë)

I Pastër prej të metave është Allahu

"Elhamdulil-Lah" (33 herë)

Lavdia dhe falënderimet i takojnë vetëm Allahut

"Allahu Ekber" (33 herë)

Allahu është më i Madhi

"La ilahe il-lAllahu uah'deHu la sheriike leH, leHul-Mulku ue leHul-Hamdu ue Hue 'alaa kul-li shej'in Kadiir" (1 herë)

Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, të Vetëm dhe të Pashok. Atij i takon Sundimi dhe Lavdia dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

- Pas kësaj thotë Ajetin Kursij, Suren el-Ikhlas, Suren el-Felek dhe Suren en-Nas.

131. Cilat janë ato gjëra që e prishin namazin?

Përgjigje: Prishësit më të rëndësishëm të namazit janë tetë, si vijon:

1. Të folurit me vetëdije (qëllimisht). Ndërsa atij që flet nga padija ose harresa, nuk i prishet namazi.
2. Të qeshurit.
3. Të ngrënit ose të pirët.
4. Zbulimi i auretit me vetëdije.
5. Devijimi i madh nga drejtimi i Kibles ose kthimi me shpinë nga kibla.
6. Lëvizjet e shumta dhe të njëpasnjëshme gjatë namazit.
7. Prishja e pastërtisë (abdesit).
8. Lënia me vetëdije e një shtylle të namazit, ose e një kushti prej kushteve të tij, ose lënia me vetëdije e një obligimi të namazit.

- Ka edhe disa veprime të ndaluara, të cilat nuk lejohet të bëhen gjatë namazit, si: Ngritja e shikimit drejt qiellit, parakalimi i imamit në veprime nga ana e atij që falet pas tij, pjesëmarrja në namazin me xhemat duke pasur erë të pakëndshme (që shqetëson të tjerët).

132. Cilat janë dobitë dhe mirësitë e namazit?

Përgjigje: Dobitë dhe mirësitë e namazit janë të shumta. Ndër më të rëndësishmet janë:

1. Namazi i fshin gabimet dhe rrëshqitjet, si dhe i shlyen mëkatet dhe veprat e këqija.
2. Namazi është shenja dalluese e të devotshmëve dhe lidhja ndërmjet robit dhe Zotit të botëve.
3. Namazi e vendos muslimanin nën mbrojtjen e Allahut të Lartësuar dhe e ruan atë nga të këqijat dhe fatkeqësitë.
4. Namazi i sjell zemrës qetësi, kraharorit çlirim dhe është kënaqësi për sytë.
5. Namazi ndalon nga shthurja dhe veprat e këqija.
6. Namazi është vepër me të cilën kërkohet ndihma e Allahut në sprova dhe vështirësi.

13. Kapitulli i zekatit

133. Çfarë është zekati?

Përgjigje: Zekati është një e drejtë e detyrueshme në një pasuri të caktuar, për një kategori të caktuar njerëzish, në një kohë të caktuar.

134. Cili është argumenti për obligueshmërinë e zekatit?

Përgjigje: Zekati është një obligim madhështor. Ai vjen përkrah me namazin dhe është një prej shtyllave të Islamit.

Argumentet për obligueshmërinë e tij gjenden në Kur'an, Sunet dhe Ixhma (konsensusin e dijetarëve).

- Nga Kur'ani: Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَآتُوا الزَّكَاةَ

"Dhe jepeni zekatin." (El-Bekareh: 43)

- Nga Suneti: Hadithi i Abdullah ibn Umerit, radijAllahu anhuma, i cili transmeton se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, ka thënë:

بُنِي الْإِسْلَامُ عَلَى خَمْسٍ شَهَادَةِ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ وَإِقَامِ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ وَحَجِ الْبَيْتِ وَصَوْمِ رَمَضَانَ

"Islami është ngritur mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, haxhi në Shtëpinë e Shenjtë dhe agjërimi i Ramazanit." [Transmeton el-Bukharij (8), Muslim (21)]

- Sa i përket ixhmasë: Muslimanët janë pajtuar njëzëri se zekati është obligim dhe se ai që e mohon obligueshmërinë e tij bën kufër (del nga feja).

135. Cilat janë pasuritë për të cilat bëhet obligim zekati? [6]

[6] Sasia minimale e pasurisë prej së cilës obligohet nxjerrja e zekatit është 85 gramë flori, ose vlera e kësaj në para, prej së cilës nxirret 2.5 % në vit. Ndërsa sasia e argjendit është 200 dërhem, e cila është e barabartë me afërsisht 595 gramë argjend, prej të cilit nxirret 2.5 % në vit. Sa u përket drithërave dhe frutave, sasia minimale që obligon

Përgjigje: Pasuritë për të cilat bëhet obligim zekati janë pesë:

1. Bagëtitë që kullosin lirshëm, e ato janë: devetë, lopët dhe delet.
2. Prodhimet që dalin nga toka.[7]
3. Dy metalet monetare, të cilat janë: ari dhe argjendi, si dhe paratë (monedhat) prej letre, të cilat zënë vendin e tyre në vlera.
4. Mallrat e tregtisë.
5. Mineralet dhe thesaret e gjetura.

136. Cilat janë kushtet e obligueshmërisë së zekatit?

Përgjigje: Kushtet e obligueshmërisë së zekatit janë pesë:

1. Islami.
2. Liria (të mos jetë rob).
3. Posedimi i nisabit (pragut minimal të pasurisë që e bën zekatin obligim).
4. Qëndrueshmëria e pronësisë (domethënë pasuria të jetë në pronësi të plotë dhe të qëndrueshme të personit).
5. Kalimi i një viti hënor në posedim për arin dhe argjendin (si dhe paratë që zënë vendin e tyre), bagëtitë që kullosin lirshëm, dhe mallrat e tregtisë.

137. Cilët janë përfituesit e zekatit?

Përgjigje: Përfituesit e zekatit janë ata që e meritojnë atë. Ata janë në tetë kategoritë që Allahu i Lartësuar i ka përmendur në Fjalën e Tij:

إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ لِلْفُقَرَاءِ وَالْمَسَاكِينِ وَالْعَامِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ وَفِي الرِّقَابِ وَالْغَارِمِينَ وَفِي سَبِيلِ اللَّهِ وَابْنِ السَّبِيلِ ۖ فَرِيضَةً مِنَ اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

"Vërtet, zekati u takon vetëm të varfërve, nevojtarëve, atyre që janë të angazhuar për mbledhjen e tij, atyre zemrat e të cilëve duhen afruar (drejt Islamit), për lirimin

nxjerrjen e zekatit është 5 *Eusuk*, e cila është afërsisht 653 kg, prej të cilit 10% nxirret zekat, nëse është ujitur me ujin e shiut dhe pa shpenzime, dhe 5% nëse është ujitur prej dorës së njeriut apo me shpenzime. Ky zekat nxirret në çastin e korrjes apo mbledhjes së tyre.

[7] Sa i përket asaj që del nga toka, si drithërat dhe frutat, zekati i tyre nxirret në kohën e korrjes ose vjeljes. Ndërsa, sa i përket mineraleve dhe thesareve të varrosura të cilat i gjen dikush, zekati i tyre nxirret menjëherë sapo gjenden. Kurse, sa i përket këlyshëve të bagëtive që kullosin dhe fitimit nga tregtia, viti i zekatit të tyre llogaritet në krye të çdo viti hënor, sipas përllogaritjes bazë.

e robërve, borxhlinjve, atyre që luftojnë në rrugën e Allahut dhe udhëtarit të mbetur në rrugë. Ky është obligim nga Allahu. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë." [Et-Teubeh, 60]

138. Cilat janë dobitë dhe mirësitë e zekatit?

Përgjigje: Dobitë dhe mirësitë e zekatit janë të shumta. Prej tyre janë:

1. Ndihma për të varfrit, të dobëtit dhe nevojtarët.
2. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet muslimanëve dhe përforcimi i lidhjeve të dashurisë ndërmjet të pasurve dhe të varfërve e nevojtarëve.
3. Pastrimi dhe fisnikërimi i shpirtit, si dhe largimi i tij nga cilësitë e koprracisë dhe lakmisë.
4. Sjell bereqet në pasuri, shtim të saj dhe kompensim nga Allahu i Lartësuar.
5. Është shkak për zbritjen e mirësive dhe largimin e të këqijave dhe ndëshkimeve.

14. Kapitulli i agjërimit

139. Çfarë është agjërimi?

Përgjigje: Agjërimi është adhurimi ndaj Allahut të Lartësuar duke u privuar (përmbajtur) nga ngrënia, pirja dhe të gjitha gjërat që e prishin agjërimin, që nga agimi i vërtetë deri në perëndimin e diellit.

140. Cili është argumenti për obligueshmërinë e agjërimit të muajit Ramazan?

Përgjigje: Agjërimi i muajit Ramazan është një prej shtyllave të Islamit dhe një prej detyrimeve të tij madhore.

Argumenti për obligueshmërinë e tij gjendet në Kur'an, Sunet dhe Ixhma (konsensusin e dijetarëve).

- Sa i përket Kur'anit, Allahu i Lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

"O ju që keni besuar! Ju është bërë detyrë agjërimi, ashtu siç u është bërë detyrë edhe atyre (popujve) që ishin para jush, që të bëheni të devotshëm." [El-Bekareh: 183]

- Sa i përket Sunetit, transmetohet nga Abdullah Ibn Umeri, radijAllahu anhuma, se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, ka thënë:

بُنِيَ الْإِسْلَامُ عَلَى خَمْسٍ شَهَادَةِ أَنْ لَا إِلٰهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ وَإِقَامِ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ وَحَجِّ الْبَيْتِ۞ وَصَوْمِ رَمَضَانَ

"Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë dhe agjërimi i Ramazanit." [Transmeton el-Bukharij (8), Muslim (21)]

- Sa i përket ixhmasë: Muslimanët janë pajtuar njëzëri se agjërimi i muajit Ramazan është obligim dhe se ai që e mohon obligueshmërinë e tij bën kufër (del nga feja).

141. Cila është urtësia e ligjësimit të agjërimit?

Përgjigje: Agjërimi është ligjësuar për një urtësi madhështore, e cila është realizimi i devotshmërisë ndaj Allahut të Lartësuar, duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

"O ju që keni besuar! Ju është bërë detyrë agjërimi, ashtu siç u është bërë detyrë edhe atyre (popujve) që ishin para jush, që të bëheni të devotshëm." [El-Bekareh: 183]

Po ashtu, Profeti, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, ka thënë:

مَنْ لَمْ يَدَعْ قَوْلَ الزُّورِ وَالْعَمَلَ بِهِ فَلَيْسَ للَّه حَاجَةٌ فِي أَنْ يَدَعَ طَعَامَهُ وَشَرَابَهُ

"Kush nuk heq dorë nga fjala e rreme dhe veprimi me të, Allahu nuk ka nevojë që ai të heqë dorë nga ushqimi dhe pija e tij." [Transmeton el-Bukharij (1903)]

142. Cilat janë kushtet e obligueshmërisë së agjërimit?

Përgjigje: Kushtet e obligueshmërisë së agjërimit janë gjashtë:

1. Islami (jomuslimanit nuk i pranohet agjërimi).
2. Arritja e moshës së pubertetit.
3. Logjika (të jetë i shëndoshë mendërisht).
4. Aftësia për të agjëruar.
5. Qëndrimi në vendbanim (mosqenia udhëtar).
6. Të jetë e pastër nga menstruacionet dhe lehonia.

143. Cilat janë arsyet që e lejojnë mosagjërimin gjatë ditës së Ramazanit?

Përgjigje: Arsyet që e lejojnë mosagjërimin në Ramazan janë pesë:

1. Sëmundja ose pleqëria, kur agjërimi shkakton vështirësi dhe është i pamundur.
2. Udhëtimi.
3. Menstruacionet dhe lehonia.
4. Shtatzënia, kur agjërimi shkakton vështirësi për gruan shtatzënë ose dëm për foshnjën e saj.
5. Gjidhënia, kur agjërimi shkakton vështirësi për nënën gjidhënëse ose dëm për foshnjën e saj.

144. Cilat janë gjërat që e prishin agjërimin?

Përgjigje: Gjërat që e prishin agjërimin janë shtatë:

1. Marrëdhëniet intime.
2. Dalja e spermës me dëshirën e personit.
3. Ngrënia ose pirja me vetëdije.
4. Çdo gjë që zë vendin e ushqimit ose pijes, si:
    - injeksionet ushqyese,
    - transfuzioni i gjakut te agjëruesi,
    - dializa e veshkave.
5. Nxjerrja e gjakut me hixhame, dhe i njëjti gjykim vlen edhe për dhurimin e gjakut.
6. Provokimi i të vjellave me qëllim, pra nxjerrja e ushqimit ose pijes nga stomaku me vetëdije.
7. Dalja e gjakut të menstruacioneve ose lehonisë.

145. Kur konsiderohet se e bëjnë të pavlefshëm agjërimin gjërat që e prishin atë?

Përgjigje: Gjërat që e prishin agjërimin nuk e bëjnë të pavlefshëm atë, përveçse nëse plotësohen tre kushte:

1. Të jetë i dijshëm, si për gjykimin fetar, ashtu edhe për kohën (pra ta dijë se është në kohën e agjërimit).
2. Të jetë i vetëdijshëm (të mos ketë harruar).
3. Të veprojë me zgjedhjen e tij, jo i detyruar.

146. Cilat janë gjërat që mund t'i bëjë agjëruesi dhe nuk konsiderohen prej prishësve të agjërimit?

Përgjigje: Ka disa gjëra që agjëruesi mund t'i bëjë dhe ato nuk e prishin agjërimin. Prej tyre janë:

1. Përdorimi i pikave për sy dhe pikave për vesh. Ndërsa pikat për hundë ndikojnë në agjërim (nuk lejohen nëse arrijnë në fyt).
2. Përdorimi i pompës për astmë dhe maskës së oksigjenit.
3. Përdorimi i injeksioneve jo ushqyese, si injeksionet kundër dhimbjes, si dhe vaksinat dhe insulina për të sëmurët me diabet.

4. Shijimi i ushqimit, me kusht që të mos hyjë asgjë në bark.
5. Përdorimi i supozitorëve dhe klizmave [ilaçeve dhe lëngjeve që futen nga vrima anale].
6. Gëlltitja e pështymës.
7. Përdorimi i parfumit. Ndërsa temjani është më mirë të lihet.
8. Freskimi me ujë dhe noti.
9. Dalja e lëngut paraejakulues (medhij), si dhe ejakulimi me dalje të spermës gjatë gjumit, sepse kjo ndodh pa dëshirën e njeriut.
10. Përdorimi i misvakut dhe larja e dhëmbëve me pastë, duke u ruajtur që të mos hyjë asgjë në bark.
11. Ngrënia ose pirja nga harresa.
12. Përdorimi i endoskopisë së stomakut (gastroskopisë).

147. Cilat janë veprat e pëlqyera gjatë agjërimit në Ramazan?

Përgjigje: Është e pëlqyeshme që agjëruesi në Ramazan të kujdeset për këto vepra:

1. Të hajë syfyr, duke e vonuar atë deri pak para agimit.
2. Ta shpejtojë iftarin sapo të perëndojë dielli.
3. Të bëjë dua gjatë agjërimit.
4. Të japë sa më shumë sadaka.
5. Të falë namazin e natës, ndërsa burrat të falin namazin e teravive me xhemat.
6. Të kryejë umre.
7. Të lexojë sa më shumë Kur'an.
8. Ta përmendë sa më shumë Allahun e Lartësuar (dhikër).
9. Të përpiqet sa më shumë në dhjetë netët e fundit të Ramazanit, duke shtuar veprat e mira.
10. Të bëjë i'tikaf, që është qëndrimi në xhami për t'iu përkushtuar adhurimit të Allahut të Lartësuar, veçanërisht gjatë dhjetë netëve të fundit të Ramazanit, duke ndjekur shembullin e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, dhe duke kërkuar Natën e Kadrit.

148. Cilat janë dobitë dhe urtësitë e agjërimit?

Përgjigje: Dobitë dhe urtësitë e agjërimit janë të shumta. Prej tyre janë:

1. Realizimi i devotshmërisë, duke zbatuar urdhrat e Allahut dhe duke iu larguar ndalesave të Tij.
2. Edukimi i vetes me virtyte të larta morale, si durimi dhe butësia.
3. Përkujtimi i mirësive të Allahut ndaj robit, si ushqimi dhe pija.
4. Përkujtimi i nevojës së të varfërve, për t'u solidarizuar me ta dhe për t'u bërë mirësi.
5. Ruajtja e shëndetit dhe mirëqenies së trupit.

15. Kapitulli i haxhit

149. Çfarë është haxhi?

Përgjigje: Haxhi është: shkuarja në Mekë për ta adhuruar Allahun e Lartësuar, në një kohë të caktuar, për të kryer rite të caktuara.

150. Cili është argumenti për obligueshmërinë e haxhit?

Përgjigje: Haxhi në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut është një prej shtyllave të Islamit dhe një prej obligimeve më të mëdha të tij.

Argumentet për obligueshmërinë e tij gjenden në Kur'an, Sunet dhe Ixhma (konsensusin e dijetarëve).

- Sa i përket Kur'anit, është Fjala e Allahut të Lartësuar:

وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا ۚ وَمَن كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ

"E çdo njeri që ka mundësi e ka obligim ta bëjë Haxhin për Allahun. E kush e mohon këtë, le ta dijë se Allahu nuk ka nevojë për askënd prej krijesave." [Al 'Imran, 97]

- Sa i përket Sunetit, transmetohet nga Abdullah Ibn Umeri, radijAllahu anhuma, se i Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*, ka thënë:

بُنِيَ الْإِسْلَامُ عَلَى خَمْسٍ شَهَادَةِ أَنْ لَا إِلٰهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ وَإِقَامِ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءِ الزَّكَاةِ وَحَجِّ الْبَيْتِ وَصَوْمِ رَمَضَانَ

"Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë dhe agjërimi i Ramazanit." [Transmeton el-Bukharij (8), Muslim (21)]

- Sa i përket ixhmasë: Muslimanët janë pajtuar njëzëri se haxhi është obligim një herë në jetë për atë që ka mundësi dhe se ai që e mohon obligueshmërinë e tij bën kufër (del nga feja).

151. Cilat janë kushtet e obligueshmërisë së haxhit?

Përgjigje: Kushtet e obligueshmërisë së haxhit janë pesë:

1. Islami (jomuslimanit nuk i pranohet haxhi).
2. Logjika (të jetë i shëndoshë mendërisht).
3. Arritja e moshës së pubertetit.
4. Liria e plotë (të mos jetë skllav).
5. Mundësia.

152. Cilat janë llojet e riteve të haxhit?

Përgjigje: Llojet e haxhit janë tre:

- Së pari: Temettu': Është hyrja në ihram për umre gjatë muajve të haxhit, pastaj dalja nga ihrami pas përfundimit të umres, e më pas hyrja përsëri në ihram për haxh në Ditën e Teruijes, e cila është dita e tetë e muajit Dhul-Hixhxheh.
- Së dyti: Kiran: Është hyrja në ihram për umren dhe haxhin njëkohësisht.
- Së treti: Ifrad: Është hyrja në ihram vetëm për haxhin.

Lloji më i mirë i haxhit është haxhi temettu', më pas haxhi kiran, më pas haxhi ifrad.

- Ai që kryen haxhin kiran dhe ai që kryen haxhin ifrad i kryejnë të njëjtat rite të haxhit. Dallimi mes tyre është se ai që kryen haxhin kiran e ka detyrë të therë kurban (hedj), ndërsa ai që kryen haxhin ifrad nuk e ka detyrë therjen e kurbanit.
- Së pesti: Kur vjen Dita e Teruijes, që është dita e tetë e muajit Dhul-Hixhxheh, është e pëlqyeshme që muslimani të hyjë në ihram për haxh nga vendi ku ndodhet. Ai lahet, parfumoset nëse ka mundësi, vesh rrobat e ihramit dhe bën nijetin e thotë:

Lebejke Allahumme haxhxhen

O Allah, po të përgjigjem Ty me haxh

Pastaj e shton sa më shumë telbijen:

"Lebejke Allahumme lebejk, lebejke la sheriike leke lebejk, innel-hamde uen-ni'mete leke uel-mulk, la sheriike lek"

Të përgjigjem Ty, o Allah, të përgjigjem! Të përgjigjem Ty, Ti nuk ke ortak në adhurim, të përgjigjem! Vërtet, lavdia, mirësitë dhe sundimi janë vetëm për Ty. Ti nuk ke ortak në adhurim.

Dhe vazhdon ta thotë telbijen derisa të gjuajë Xhemretul-'Akabeh (shtyllën e madhe ku gjuhen guralecët) në Ditën e Kurbanit.

- Së gjashti: Shkon në Mina, ku fal namazin e drekës, ikindisë, akshamit, jacisë dhe sabahut. Namazet katër-rekatëshe i fal nga dy rekate (me shkurtim), secilin në kohën e vet, pa i bashkuar.
- Së shtati: Kur lind dielli në ditën e nëntë të Dhul-Hixhxhes, niset për në Arafat me qetësi dhe dinjitet. Atje fal drekën dhe ikindinë të bashkuara në kohën e drekës, me një ezan dhe dy ikamete, duke i shkurtuar me nga dy rekate.

Duhet të sigurohet se ndodhet brenda kufijve të Arafatit, ndërsa i gjithë Arafati është vendqëndrim. Më pas e shton sa më shumë dhikrin dhe lutjen, duke u kthyer nga kibla dhe duke i ngritur duart, duke pasuar shembullin e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*. Nuk duhet të largohet nga Arafati derisa të perëndojë dielli.

- Së teti: Pasi të perëndojë dielli, largohet nga Arafati për në Muzdelife, me qetësi dhe dinjitet, duke vazhduar telbijen. Kur arrin atje, fal akshamin dhe jacinë të bashkuara, ndërsa jacinë e shkurton në dy rekate. Pastaj qëndron në Muzdelife derisa të falë sabahun dhe të skuqet lindja. Pas namazit të sabahut, e shton sa më shumë dhikrin dhe lutjen, duke u kthyer nga kibla dhe duke i ngritur duart, duke ndjekur shembullin e Profetit, *sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*.
- Së nënti: Para lindjes së diellit niset nga Muzdelife për në Mina, duke vazhduar telbijen. Nëse ka ndonjë arsye, si gratë, të dobëtit ose ai që i shoqëron ata, nuk ka problem të niset për në Mina në fund të natës (pa pritur sabahun).

Me vete merr shtatë guralecë për gjuajtjen e Xhemretul-Akabes. Sa u përket guralecëve të tjerë, i mbledh në Mina (ditët e tjera). Nëse i mbledh të gjithë guralecët në Mina, nuk ka asgjë të keqe.

- Së dhjeti: Kur haxhiu arrin në Mina ditën e Kurban Bajramit (10 Dhul-Hixhxheh), ai kryen veprimet e mëposhtme:
- Gjuan Xhemretul-'Akabeh (shtyllën e madhe), e cila është më afër Mekës, me shtatë guralecë njëri pas tjetrit, duke thënë "Allahu Ekber" me çdo guralec që hedh.
- Ther kurbanin. Kjo është detyrë për atë që kryen temettu' ose kiran, ndërsa nuk është detyrë për atë që kryen haxhin ifrad.
- Rruan kokën ose shkurton flokët. Rruajtja është më e vlefshme, ndërsa gruaja i shkurton flokët sa maja e një gishti (afërsisht sa një nyjë gishti).

Kjo renditje është më e pëlqyeshmja. Megjithatë, nëse disa prej këtyre veprimeve kryhen para të tjerave, nuk ka asnjë problem.

Me gjuajtjen e guralecëve dhe rruajtjen ose shkurtimin e flokëve, haxhiu hyn në lirimin e parë (et-tehal-lul el-eu-uel). Prandaj, ai mund të veshë rrobat e zakonshme dhe i lejohet çdo gjë që i ishte ndaluar gjatë ihramit, përveç marrëdhënieve bashkëshortore. Edhe nëse lirimin e parë e vepron vetëm me gjuajtjen e guralecëve, nuk ka ndonjë problem.

- Së njëmbëdhjeti: Më pas, haxhiu shkon në Mekë për të kryer tauafin e haxhit (ifadah) dhe bën sa'jin ndërmjet Safas dhe Meruas. Kur i mbaron këto, ai hyn në lirimin e dytë (et-tehal-lul eth-thani). Me këtë lirim i lejohet çdo gjë, edhe marrëdhëniet bashkëshortore.

  Haxhiut i lejohet ta shtyjë tauafin e haxhit deri pas ditëve të qëndrimit në Mina dhe përfundimit të ditëve të gjuajtjes së guralecëve (në përfundimintë ditëve të teshrikut). Nëse tauafi i haxhit është veprimi i fundit i haxhit, ai i mjafton edhe në vend të tauafit të lamtumirës (tauaful-ueda').

- Së dymbëdhjeti: Pas kryerjes së tauafit të haxhit (ifadah) në ditën e Kurban Bajramit, haxhiu kthehet në Mina dhe kalon natën aty në netët e 11-të, 12-të dhe 13-të Dhul-Hixhxhes, që janë netët e ditëve të teshrikut.

Nëse nxiton dhe largohet pas dy netësh (pas ditës së 12-të), kjo është e lejuar.

- Së trembëdhjeti: Gjuajtja e tre xhemarateve me guralecë bëhet pas kalimit të diellit nga zeniti (pas drekës) në ditën e 11-të dhe të 12-të të Dhul-Hixhes. Po kështu vepron edhe në ditën e 13-të, nëse qëndron edhe atë ditë.
- Ai fillon me shtyllën e vogël (xhemratu sugra), e cila është më e largëta nga Meka. Pasi e gjuan, ndalet dhe lutet gjatë.
- Pastaj gjuan shtyllën e mesme (xhemratu ustaa), pas së cilës gjithashtu ndalet dhe lutet gjatë.
- Më pas gjuan shtyllën e madhe, që është xhemratul-'akabeh. Pas saj nuk ndalet për lutje.

Secilën shtyllë e gjuan me shtatë guralecë njëri pas tjetrit, duke thënë "Allahu Ekber" gjatë hedhjes së çdo guraleci.

Nëse haxhiu dëshiron të nxitojë (të largohet më herët nga Mina), ai duhet të dalë prej saj para perëndimit të diellit në ditën e 12-të të Dhul-Hixhxhes. Nëse dielli perëndon ndërsa ai ndodhet ende në Mina, atëherë duhet të qëndrojë edhe ditën e 13-të dhe t'i gjuajë tri shtyllat atë ditë.

Megjithatë, më e vlefshme është që të qëndrojë, ta kalojë edhe natën e 13-të në Mina dhe t'i gjuajë shtyllat atë ditë.

I sëmuri ose i pafuqishmi mund të caktojë dikë si përfaqësues që t'i gjuajë shtyllat në vend të tij. Përfaqësuesi fillimisht i gjuan shtyllat për veten e tij, pastaj për atë që e ka ngarkuar, nga i njëjti vend, pa qenë nevoja të kthehet përsëri.

- Së katërmbëdhjeti: Kur haxhiu dëshiron të kthehet në vendin e tij (apo të largohet nga Meka), pasi t'i ketë përfunduar të gjitha veprimet e Haxhit, ai kryen tauafin e lamtumirës (i cili është vetëm shtatë rrotullime rreth Qabes, ndërsa ecja e sa'jit nuk bëhet). Ky tauaf është detyrë për të gjithë haxhinjtë, me përjashtim të gruas me menstruacione, gruas në lehoni dhe banorëve të Mekës.

Me kryerjen e këtij tauafi përfundojnë të gjitha ritualet e Haxhit. Falënderimi i takon Allahut.

154. Cilat janë shtyllat e haxhit?

Përgjigje: Shtyllat e haxhit janë katër:

1. Ihrami (hyrja në gjendjen e ihramit).
2. Qëndrimi në Arafat.
3. Tauafi i Ifadës (tauafi i haxhit).
4. Sa'ji, ecja ndërmjet Safas dhe Meruas.

155. Cilat janë obligimet e haxhit?

Përgjigje: Obligimet e haxhit janë shtatë:

1. Ihrami në Mikat.[8]
2. Qëndrimi në Arafat deri sa të perëndojë dielli, për atë që ka shkuar gjatë ditës.
3. Qëndrimi në Muzdelife natën e Kurban Bajramit.
4. Qëndrimi në Mina netët e ditëve të Teshrikut.
5. Gjuajtja e xhemrateve (shtyllave).
6. Rruajtja e kokës ose shkurtimi i flokëve.
7. Tauafi i lamtumirës, përveç gruas me menstruacione ose lehonë, si dhe përveç banorëve të Mekës.

156. Cilat janë sunetet e haxhit?

Përgjigje: Sunetet e haxhit janë të shumta. Prej tyre janë:

1. Larja (gusli) dhe parfumosja para hyrjes në ihram.
2. Tauafi i ardhjes (kauaful-kudum) për atë që bën haxhin Ifrad dhe Kiran (shtatë rrotullime rreth Qabes).

[8] Mikatet [vendet e caktuara për hyrjen në ihram] për haxhin ose umren janë pesë:
1. Dhul-Hulejfeh: Është mikati i banorëve të Medinës dhe i kujtdo që kalon nga rruga e tyre. Ai ndodhet rreth 420 km larg Mekës. Është shumë afër Medinës, por është mikati më i largët nga Meka. 2. El-Xhuhfeh: Është mikati i banorëve të Shamit (Sirisë, Jordanisë, Palestinës dhe Libanit) dhe i kujtdo që kalon nga rruga e tyre. Sot njerëzit hyjnë në ihram nga Rabig, sepse Xhuhfeja e vjetër është braktisur. Rabigu ndodhet rreth 186 km në veri të Mekës. 3. Karn el-Menazil (i njohur sot si Es-Sejl el-Kebir): Është mikati i banorëve të Nexhdit dhe i kujtdo që kalon nga rruga e tyre. Ndodhet rreth 78 km në lindje të Mekës. 4. Jelemlem: Është mikati i banorëve të Jemenit dhe i kujtdo që kalon nga rruga e tyre. Ndodhet rreth 120 km në jug të Mekës. 5. Dhatu 'Irk: Është mikati i banorëve të Irakut. Ndodhet rreth 100 km në lindje të Mekës.

3. Ecja e shpejtë në tre rrotullimet e para të tauafit të ardhjes dhe të tauafit të umres.
4. Zbulimi i shpatullës së djathtë gjatë tauafit të ardhjes dhe tauafit të umres.
5. Falja e dy rekateve pas tauafit.
6. Qëndrimi në Mina natën para ditës së Arafatit.
7. Telbija, duke filluar nga hyrja në ihram deri në gjuajtjen e xhemretul-akabes (ditën e Bajramit).
8. Bashkimi i namazit të drekës me ikindinë në Arafat, në kohën e drekës; si dhe bashkimi i namazit të akshamit me jacinë në Muzdelife menjëherë pas mbërritjes atje, për sa kohë nuk ka dalë koha e jacisë. Koha e jacisë përfundon në mesnatë.

157: Cili është dallimi ndërmjet shtyllave, obligimeve dhe suneteve të haxhit?

Përgjigje:

- Shtylla (rukni): Haxhi nuk është i vlefshëm pa të.
- Obligimi (uaxhibi): Nëse lihet pa arsye, haxhi mbetet i vlefshëm, por ai që e ka lënë e ka detyrë të therë një kurban si kompensim.
- Suneti: Kryerja e tij është e pëlqyeshme dhe e shpërblyer, ndërsa ai që e lë nuk ngarkohet me asnjë detyrim.

158. Cilat janë ndalesat e ihramit për haxh ose umre?

Përgjigje: Ndalesat e ihramit janë gjërat që i ndalohen atij që ka hyrë në ihram për haxh ose umre.

Ato ndahen në tri kategori:

- Kategoria e parë: Ndalesa që vlejnë si për burrat ashtu edhe për gratë, dhe janë tetë:
  1. Marrëdhëniet intime, kjo është ndalesa më e rëndë.
  2. Prekja ose përkëdhelja me epsh, pa arritur deri te marrëdhëniet intime.
  3. Nikahu, lidhja e kurorës martesore.
  4. Heqja e qimeve nga koka ose trupi.
  5. Prerja e thonjve.
  6. Përdorimi i parfumit.
  7. Gjuetia dhe vrasja e kafshëve të egra (që në origjinë janë të lejuara për gjueti).
  8. Veshja e dorezave.

- Kategoria e dytë: Ndalesa që vlejnë vetëm për burrat, dhe janë dy:
  1. Mbulimi i kokës me diçka që e prek drejtpërdrejt.
  2. Veshja e rrobave të qepura që mbulojnë trupin ose një pjesë të tij sipas formës së trupit.

- Kategoria e tretë: Ndalesa që vlejnë vetëm për gratë:
  1. Veshja e nikabit (mbulesës së fytyrës) ose burkës gjatë ihramit.

159. Cili është gjykimi për atë që bën diçka prej ndalesave të ihramit?

Përgjigje: Ai që kryen një nga ndalesat e ihramit është në njërën prej tri gjendjeve:

- Gjendja e parë: Ta kryejë ndalesën duke qenë i vetëdijshëm, në kujtesë, me dëshirën e tij, pa ndonjë arsye apo nevojë. Ky është gjynahqar dhe ka obligim shpagimin ose atë që kërkohet si pasojë e asaj ndalese.
- Gjendja e dytë: Ta kryejë ndalesën duke qenë i vetëdijshëm, në kujtesë dhe me dëshirën e tij, por për shkak të një nevoje. Në këtë rast, e ka obligim shpagimin ose atë që kërkohet si pasojë e asaj ndalese, por nuk ka gjynah.
- Gjendja e tretë: Ta kryejë ndalesën duke qenë i paditur, ose nga harresa, ose i detyruar, ose në gjumë. Në këtë rast nuk ka gjynah dhe as shpagim. Mirëpo, sapo të largohet justifikimi, e ka detyrë ta braktisë menjëherë atë ndalesë.

160. Cilat janë dobitë e haxhit?

Përgjigje: Dobitë e haxhit janë të shumta. Ndër më të rëndësishmet janë:

1. Tubimi i muslimanëve nga vende të ndryshme dhe me këtë forcojnë dashurinë, afërsinë dhe njohjen mes tyre.
2. Shfaqja e unitetit të muslimanëve, se ata janë një umet i vetëm; mblidhen në një vend, në një kohë dhe me një veshje të njëjtë. Nuk ka dallim midis të pasurit e të varfrit, arabit e joarabit, të bardhit e të ziut.
3. Përkujtimi i Akhiretit, duke kujtuar qëndrimin e robërve para Allahut në Ditën e Kiametit.

Suksesi vjen vetëm prej Allahut, salauatet dhe selamet qofshin për Profetin tonë Muhammedin.